



2016

Vashzat, detyra e gruas në bashkësitë arbëreshe që nga paslufta deri sot



Associazione Culturale Alборе

*“Nënës sime
që gjithmonë mbërthen zemrën time
pasionet e mia
rrënjët e mia dhe dheut tim”*

Redakuar nga Dott. Domenico Capparelli

Sommario

Hyrje.....	5
1.....	6
Shqiptarët e Italisë	6
1.1 Referime historike: Gjergj Kastrioti – Skënderbeu	6
1.2 Katundet	7
1.3 Bashkësitë arbëreshe në Itali	10
2.....	11
Shëmbëlltyra e gruas	11
2.1 Gratë nëpër botë dhe nëpër kohë	11
3.....	17
Gjuha folur nga arbëreshët	17
3.1 L’ABËRISHT	17
3.2 TRADITA GJUHËSORE DHE LETËRSIA.....	18
3.3 RUAJTJA E GJUHËS	18
3.4 ROLI I GRAVET NË RUAJTJEN E GJUHËS	19
4.....	21
Riti	21
4.1 Hyrje	21
4.2 Kisha lindore në Itali	21
4.3 Liturgjia Hyjnore	22
4.4 Motrat Baziliane “Bijat e Shën Makrinës” në Firmozë	23
4.5 Historia e një gruae që jetoi si një shenjte.....	26
4.5.1 Amaneti i Rosa Lotito-s.....	28
4.5.2 Nga ditari i Kallogreve Baziliane – dita 15 prill 1981	29
4.5.3 Kujtim i papas Vincenzo Matrangolo.....	30
4.5.5 Apostullja	31
4.6 Një murgeshë revolucionare	33
5.....	39
KOSTUMI	39
5.1 HYRJE.....	39

5.2 KOSTUMI I FESTËS	41
5.3 KOSTUMI I KUSHQIS DHE I MARTESMES	42
5.3.1 KUSHQIA	43
5.3.2 L1 MARTESMA	43
5.4 KOSTUMI I PËRDITSHME	44
5.5 KOSTUMI I LIPIT	45
6	46
NGA PASLUFTËS DERI MË SOT	46
6.1 MIGRIMET	46
6.2 SONDAZHET E STATISTIKAVE TË RRRITJES POPULLSISË	51
TABELA 1: REGJISTRIMI I QYTETIT SË FIRMOZËS	51
TABELA 2: REGJISTRIMI I QYTETIT SË UNGRËS	52
TABELA 3: REGJISTRIMI I QYTETIT SË FERMËS	53
6.3 UDHËTIMI	54
6.4 GRATË ARBËRESHË NË ARGJENTINË	55
6.5 RITUALI I MATËT	57
6.6 RRETH CONCOCTIONS: ARTIN E SHËRIMIT	58
6.7 VASHËZAT E MIJËVJEÇARIT TË TRETË	59
6.8 MIRËSEARDHJE: VLERA E MIKPRITJES SË GRAVE ARBËRESHË	60
KONKLUZIONE	63
<i>PËRFUNDIM FALËNDEROMI</i>	65

Hyrje

Qëllimi i projektit “Vashzat, detyra e gruas në bashkësitë arbëreshe që nga paslufta deri sot”, është të provojë dhe të krijojë një përfytyrim të përgjithshëm të kulturës arbëreshe. Një kalim ky, që jo fare rastësisht, fillon duke shqyrtuar e vlerësuar punën e grave përbrenda bashkësive arbëreshe, punë kjo që shpeshherë mbeti e pa treguar ose u kallëzua në mënyrë sipërfaqësore.

Vendin kryesor të veprimtarisë së “Shoqatës Kulturore Albore” e zë Arbëria. Tri katunde të vogla arbëreshe shumë afër njëri me tjetrin: Ungra, Ferma dhe Firmoza, të bashkuara nga të njëjtat rrënjë kulturore, që, mrekullisht, ruajtën gjatë kohës identitetin, traditat, gjuhën e tyre, sot kanë vështirësi të pëhapin dhe të tregojnë këtë thesar të madh kulturor i të cilit janë trashëgimtare.

Prapatokat e Arbërisë, ato që të kuptohemi, ndodhen rrëzë Parkut Kombëtar të Pulinit në rrethin e Kozencës, janë ato që vuajnë më fort ngushtësinë ekonomike e cila, gjithashtu, nxit edhe më shumë rënien shoqërore tash ekzistuese, duke shpejtuar doemos rrjedhën e braktisjes së ngulimeve arbëreshe.

Përbrenda shoqërive aq të ndryshme nga realiteti përreth, të pajisura me një sistem shoqëror të bazuar në ruajtjen e rrënjëve vetjake, detyra e gruas është pak e dukshme, qoftë nga pikëpamja e përgjithshme, qoftë edhe si shfaqje të veçanta mbrenda traditave kulturore. Pjesë kjo e rëndësishme në rindërtimin dhe rivendosjen e një përfytyrimi arbëresh.

Nga nevoja për të filluar ndërtimin e një tregimi që ka si objekt trojet tona dhe kulturën tonë, lindi ideja e këtij projekti, duke u nisur nga veprimtaria e grave nëpër katundet tona. E shkruar italisht dhe arbërisht, kjo dosje paraqet një studim të kryer drejtpërdrejt nëpër trojet etnike, një tregim që përshkon historinë e bashkësive tona dhe, njëkohësisht, do t’u japë zë dhe denjësi arbëreshëve.

[Përktheu G. Capparelli - Malcori]

Dott. Domenico Capparelli

1

Shqiptarët e Italisë

1.1 Referime historike: Gjergj Kastrioti – Skënderbeu

Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405 – 1468), prijës dhe atdhetar shqiptar, mbrojti Shqipërinë nga përpjekjet për pushtim të Perandorisë Turke Osmane për 25 vjet rresht; për këtë arsye ai çmohet si *Kreshniku i Krishtërit* dhe mbahet si hero kombëtar të popullit shqiptar, dhe i gjithë shqiptarëve kudo që ndodhen në botë.

Skënderbeu, duke ndërprerë luftën kundër ushtrisë osmane, dhe duke u vënë në krye të një njësie ushtarake tepër të fuqishme, në viti 1461 arrin në Itali, ku, në pak kohë, shpartallon kryengritësit francez dhe rivendosin në fronin mbretëror të Napolis Ferdinandin e Aragonës. Mbreti Ferdinand, mirënjohës ndaj Skënderbeut për ndihmën e patur, i fal Princit shqiptar, dhe pasardhësit të tij çifligjet e Trani-it, Sipont-it, Monte Gargano-s dhe San Giovanni Rotondo-s. Katundet të themeluar në *Puglia e Molise* nga ushtritë shqiptare bëhen ngulime referimi për të gjithë ata që kanë ndër mend të largohen nga Principatat e Arbërit, në atë kohë të shkretuara nga lufta e pambarim në mbrojtje nga pushtuesi osman.

Me vdekjen e Skënderbeut (1468), populli i Arbërit nuk ka më mundësi të përballojë sulmet e hordhive turke, dhe pak nga pak bien qytetet kryesore si Kruja e Korone. Gjoni, djali i Skënderbeut, i cili dinte shumë mirë nga i ati se në rast humbjeje e vetmja rrugë shpëtimi ishte Italia, udhëheq mijëra të ikurish drejt bregdetit italian. Disa prej tyre zënë vend në krahinën e Puljas, disa të tjerë vazhdojnë rrugën kah Siqilia, kurse pjesa më e madhe zgjedh si vend ku të strehohet Kalabrinë, duke themeluar katundet arbëreshe në dy shpatet e Malit Pulinë, nëpër kodrat e Silës Greke dhe në vargmalin që karakterizon Rrethin e Kozencës. Janë këto shtegtime popujsh, ku burrat marrin me vete gra, fëmijë e pleq, shumë herë të udhëhequr shpirtërisht nga priftërinjtë e tyre. Arbëreshët përgjithësisht janë të ardhur nga pjesa jugore të Shqipërisë së ditëve tona, flasin toskërishten, djalekti jugor i shqipes, dhe ruajnë fenë e krishterë me ritin bizantin, shumë e përhapur në këto treva shqiptare.

Ngulimet e reja e arbëreshëve nëpër krahinat jugore të Italisë janë një gjë fare e natyrshme sepse këtu, deri pak kohë para ardhjes së tyre, ka qenë e pranishme tradita bizantine. Krijohen kështu qendra të reja banimi, dhe nuk është për t'u çuditur, pjesa më e madhe e tyre ndërtohet rreth manastirave të vjetra, e nuk është një rastësi, në qoftë se është ngaherë një kishtar ai që nënshkruan marrëveshjet midis çifligtarëve dhe të nënshtruarëve të rinj.

Lindin kështu bashkësi të vërteta me tradita kulturore, kishtare, liturgjike, me rregullore, me klerin e vet si edhe me peshkopët e tyre.

Por të porsaardhurit nga Arbëria nuk e kanë të lehtë ngulimin e tyre në tokat e reja; marrëdhëniet me popullatën vendase nuk shkojnë mirë, as tregojnë ndonjë farë orvatje për një bashkëpunim të mundshëm, si gjithashtu nuk janë të mira marrëdhëniet me çifligarët vendas. Gjuha e ndryshme, nevoja për t'iu përshtatur jetës së re, kujtimi i gjendjes para ikjes, varfëria e made (sidomos për shkak të çifligarëve) nuk lehtësojnë krijimin e marrëdhënieve miqësore me banorët e vendit, të cilët, nga ana e tyre, pak durojnë praninë e të porsaardhurve.

Një aforizëm kalabrez thotë: “Po rastisi të takosh një shqiptar dhe një ujk, qëllon shqiptarin dhe shpëton jetën e ujkun”, duke nënvizuar shpirtin grindës që dallon shqiptarin.

Shqiptarët pësojnë dhunë, dhe e shpërblejnë atë me çetime, pretime të egra kundër popullsisë vendase, duke krijuar urrejtje, mëri, dhe lufta kapitëse. Megjithatë, shqiptarët i drejtohen parësisë së vendit me një mori kërkesash të cilat synojnë t'i barazojnë me popullsinë kalabreze, duke nisur një proces i cili u siguron një pozitë shoqërore, duke i bërë ata të zotët e historisë politike, kulturore dhe shoqërore të Kalabrisë së Këtejshme (*Çiteriore* = e këtejshme). Qysh në epokën mesjetare në krahinën e Kalabrisë dalloheshin dy treva gjeografike që, gjatë kohës, do të njiheshin si Kalabria Çiteriore (ose Kalabria Latine) dhe Kalabria Ulteriore (ose Kalabria Greke). Kalabria Latine (ose Çiteriore) i përkon zonës më veriore të krahinës dhe përbën, qysh në vitin 1147, një njësi administrative, më parë me Mbretërinë e Siqilisë, pastaj me Mbretërinë e Napolis, dhe, më në fund, me atë të Dy Siqilive.

1.2 Katundet

Vendësit italian e kanë pasur të pamundur futjen e tyre në bashkësitë të porsa krijuara, nëpër ato vende armiqësore, mbas vite shtegtimesh, nga të ikurit nga Dheu i Arbërit. Sepse ndër ato treva nuk ekzistonte dot një formë qeverie, ose organizimi feudal, dhe as ekzistonte ndonjë farë mundësie për ta krijuar atë, sepse Princërit e Arbërit kishin braktisur mërgimtarët, duke parapëlqyer të qëndronin pranë Oborrit Mbretëror të Napolis.

Arbëreshët që të mos cenonin njësinë e vet, përballë asaj gjendje armiqësore, krijojnë forma demokracie të brendshme, si edhe organizata të frymëzuara nga role barazuese. Gjatë dekadave që do të vijojnë, marrëdhëniet midis dy popullatave fillojnë, dalngadalë, të normalizohen, por pak ndryshime prekën në jetën shoqërore arbëreshe. Shtëpitë, tashmë prej guri, në vend të kasolleve, janë ndërtuar mu aty ku kanë qenë banesat e para, po në atë mënyrë vendosjeje, duke marrë, kështu,

zhvillim ndërtimi urbanistik i gjitonisë ¹, e cila s'është gjë tjetër veçse vendi më i madhë në krahasim me atë familjar, për të mbajtur marrëdhënie shoqërore, brenda së cilës familja ndryshon sistemin hierarkik të organizimit të vet.

Gjitionia, kështu, bëhet projektim, ose më mirë paraqitje, e fushës private brenda grupit, dhe njëkohësisht forcon ndjenjën e përkatësisë në atë.

Brezat e ardhshëm rritën dhe brumosën me këto parime, ato nuk pranojnë asnjë lloj autoriteti të tepruar, si gjithashtu, nuk pranojnë asnjë formë pushteti shtypës, duke lakmuar drejtësinë, dhe duke çmuar ngaherë pjesëmarrjen në jetën shoqërore dhe të qyteteruar.

Katundet u formuan mbi kulturën e mërgimtarëve, si edhe, sidomos, mbi kërkesën për të plotësuar disa nevoja parësore. U duheshin, në radhë të parë, burimet, pastaj katundi të ndodhej fare pranë pyllit, kështu t'u jepte mundësinë për të ushtruar gjahun, dhe t'u siguronte kullotat dhe drutë për vatrat. Zbuluan rrjedhat e lumenjve që të vendosnin një lidhje midis katundeve dhe fushës, dhe kurrizet e kodrave, ku të kalonte udha, dhe, më në fund, kërkuan treva të bëgata me lënde ndërtimi. Kur të gjitha këto kërkesa qenë plotësuar, bashkësitë arbëreshe filluan ndërtimin e katundeve të tyre.

Sot, bashkësitë me prejardhje arbërore po jetojnë një proces të madh shndërrimi kulturor.

Në Kalabri, katundet ku flitet arbërishtja janë gjithsej 30 (23 njësi administrative, dhe 7 bashkësi të varura), për një popullatë banuese mbi pesëdhjetë mijë banorë.

Gjatë viteve pesëdhjetë dhe shtatëdhjetë, këto bashkësi pësojnë ndryshime të thella dhe rrënjësore. Kalimi nga një shoqëri bujqësore të pasluftës në atë industriale të viteve gjashtëdhjetë, pushtoi botën arbëreshe duke cenuar, në mënyrë të pakthyeshme, disa tipare të veçanta. Me të marrë këmbë e ashtuquajtura *shoqëria e bëgatisë*, janë zhdukur shumë tipare të traditës, dhe shumë pjesë në veshjet arbërore: modernizimi shkaktoi një humbje objektive të pakthyeshme që nxori jashtë përdorimit veshjet e traditës, disa pamje të jetës së përbashët si këngët polifonike, të cilat, ende sot, dëshmojnë rrënjët e lashta kulturore.

Kanë mbijetuar, mbas këtij sulmi në drejtim të kulturës materjale, dhe të sjelljeve jetësore të përditshme, vlerat etike të kulturës popullore arbëreshe. Mjafton të shihen disa rrethana të veçanta, si për shembull: kulti që ruajnë për të vdekurit, martesat (sidomos pjesa që paraprin atë), ose domethëniet simbolike të zjarrit, si pjesë thirrëse në pjesëmarrje festive. Sulmin më të fortë kulturës

¹ Kuptimi i fjalëpërfjalshëm: lagje, por shprehja përmban edhe një domethënie më të zgjeruar, ajo cakton një vend të posaçëm të fshatit, si edhe njerëzit, dhe familjet që në atë vend banojnë. Në menyrë tradicionale ajo përbëhet nga një shesh i vogël rreth të cilit hapën dyert e katër-pesë shpive; gjitonitë e ndryshme, që përbënin katundin, ishin të ndërlidhura midis tyre nga një gërshetim rrugicash që pastaj derdheshin në një udhë kryesore, e cila lidhej me sheshin kryesor, zakonisht "sheshi i kishës" ku hapeshin dyqanet dhe punishtet, dhe, në daljen e katundit, me kronjet. Brenda gjitonive jeta e të gjithëve zhvillohej, dhe në shumë raste, edhe sot e kësaj dite zhvillohet, pothuajse ngaherë në marrëdhënie të qëndrueshme midis tyre, ose në bashkëpunim. (P. Bruno, M. Celestino, *Viaggio in Arbëria. Guida attraverso gli itinerari turistico-culturali dei opaesi arbëreshë delle Calabrie*, Ed. Prometeo, Castrovillari, 2001.)

arbëreshe, megjithatë, vjen, mbi të gjitha, nga mjetet e komunikimi të sotëm të telematikës dhe të informatikës që ndikojnë rëndë në procesin e zhdukjes së gjuhës. Televizioni, radioja, shtypi, shkolla shpien ngaherë e më shumë të shtrëngohet hapësira ku flitet arbërishtja, duke çuar këto zona gjuhësore të mbetën pa identitet.

Frymat e reja kulturore të viteve gjashtëdhjetë sollën një ndryshim në prirjet: refuzohet përshtatshmëria ndaj një modeli të përbashkët dhe mbisundues, për t'i dhënë gjallëri kulturës së fshatit. Arbëreshët, duke zbuluar kujtesën e tyre historike, duke vënë në përdorim gjuhën e nënës, kanë krijuar mundësinë për të treguar veçoritë e tyre. Shoqatat që erdhën duke u krijuar gjatë kësaj kohe, sidomos në rrethin e Kozencës, janë pasojat e kësaj dukurie.

Gjatë dekadave të fundit, sidomos me meritën e Lidhjes Italiane të Pakicave Arbëreshe ², fillon një veprimtari e përbashkët midis popullatës arbëreshe dhe institucionet kulturore shqiptare, që ka si qëllim këmbimin kulturor, artistik dhe shkencor midis dy tokave.

Për Shqipërinë kjo nuk është një periudhë e lehtë. Shqipëria jeton diktaturën e Enver Hoxhës ³, i cili, në fillim, kishte qenë i dashur nga populli, kurse, më vonë, nisi një ftohje në udhëheqjen e tij për shkak të politikës së izolimit që tash Shqipëria po jeton. Zhduken njerëzit më në zë nga fushat intelektuale dhe artistike. Ndalohen botimet jashtë sferës partiake (lejohen vetëm libret me kapak të kuq e që mbajnë emrin e diktatorit). Muzika e ligjshmë është vetëm ajo klasike o folkloristike. Që nga viti 1976 regjimi bëhet më i egër: asnjëri mund të dalë jashtë vendit, dhe pakkush mund të futet në Shqipëri: ndër këta të pakët, të privilegjuar janë arbëreshët. Marrëdhëniet midis Shqipëri dhe Arbëri, në të vërtetë, nuk kanë njohur kurrë ndërprerje, as gjatë vitit 1985, që me rastin e Festivalit të Argjirokastrës ⁴, disa muzikantë me origjinë nga Ungra kanë qenë të ftuar të merrnin pjesë.

Mbas rënies së diktaturës në Shqipëri, fillon ajo që mund të quajmë: “Dalja Biblike”, pjesa më e madhe të së cilës në drejtim të Italisë.

Është viti 1991, ai që regjistron eksodet e mëdha. Pamjet nga televizori na tregojnë dyndje njerëzish: gra, burra, fëmijë që gëlonin anije dhe trape në drejtim të lirisë, në drejtim të një vendi më njerëzor. Arbëria është gati të presë e të mirëpresë vëllezërit e bregut matanë të Detit Jon, përqaftimi, më në fund, me “Gjakun tonë të shprishur” ⁵.

Ka vetëm një ndryshim në valat e migrimeve shqiptare në Itali: shkrirja e plot me popullatën e vendit për gjithë ata që qëndrojnë në zonat e veriut të Italisë, kurse për ata që zgjedhin fshatrat e jugut, sidomos katundet e Arbërisë, do të vazhdojnë të ruajnë indentitetin e tyre.

² Lega Italiana delle Minoranze Albanesi: fondata nel 1980 da Mario Brunetti. <http://it.wikipedia.org>

³ E. Hoxha lindi në Argjirokastër (1908-1985). Udhëheqi diktaturën shqiptare që nga viti 1944 deri kur vdiq (1985). D. Guagliardi, *Influssi culturali e politici nella lotta d'indipendenza d'Albania*, in *Rilindja arbëreshe*, anno V, 1988.

⁴ Festivali i Argjirokastrit është festivali i muzikës popullore shqiptare, i cili mbahet ende sot e këtyre ditëve.

⁵ “Gjaku Ynë i Shprishur”, shprehje e përdorur nga arbëreshët për të treguar tërë popullatën arbëreshe.

1.3 Bashkësitë arbëreshe në Itali

Katundet arbëreshe mbajnë dy emra, italisht dhe arbërisht. Ky i fundit, emri arbërisht, është ai që arbëreshët përdorin. Bashkësitë e Arbërisë janë të ndara në një mori zonash etno-gjuhësore që i përgjigjen zonave të veçanta të Italisë së jugut. Megjithatë, disa katunde, afro tridhjetë, janë shkrire me popullatën vendase dhe kanë humbur, bashkë me gjuhën, edhe identitetin e tyre, kurse disa të tjera janë krejtësisht të zhdukura. Sot, në Itali, katundet me prejardhje shqiptare janë 41 dhe 9 njësi administrative të varura, të shpërndara në 7 krahina të Italisë jugore dhe ishullore, popullata gjithsej është tek afro 100 mijë banorë. Ky numër është ngaherë i përafërt: regjistrimi zyrtar i popullatës, viti 1921, jep 82.282 arbëreshë; ai i vitit 1997, jep 197.000 arbëreshë, kurse, gjatë vitit 1998, Ministria e Punëve të Brendshme llogariste popullatën arbëreshe tek 98.000 banorë.

Kalabria është krahina italiane me më shumë ngulime arbëreshe. Tridhjetë katunde, disa fare pranë njëri me tjetrin, me afro 58.425 banorë. Shumica ndodhet në rrethin e Kozencës. Bashkësi të rëndësishme ndodhen në Siqili, 5 katunde, në veçanti në zonën e Palermos, me afro 53.528 banorë. Krahina Pulja me një përqindje të ulët, katër katunde me afro 12.816 arbëreshë. Kështu të shpërndarë: rrethi i Foxhas me katundet Kazallveqi dhe Qeuti; rrethi i Tarantos me Shën Marxanin, e në qytetin kryesor të Barit kemi Kasano Murxhe. Të tjera katunde ndodhen në Molize, 13.877 banorë, të ndarë në Shën Pali, Shën Kostandini, Barilli, Xhinestra dhe Mashkiti. Shumë të vogla bashkësitë arbëreshe që ndodhen në Kampania, 2.226 banorë, dhe ato që ndodhen në Abruxo, 510 banorë.

Historikisht, katundi më i madh arbëresh, qoftë nga numri i banorëve arbërishtfolës, qoftë edhe nga madhësia e ngulimit, ky është katundi i Horës së Arbëreshëve në rrethin e Palermos. Të tjera katunde arbëreshe me epërsi numerike, që erdhën duke u zhvilluar këto dekadat e fundi, por që nuk ruajnë plotësisht gjuhën arbëreshe, janë: Spixana në rrethin e Kozencës, dhe Shë Marxani në rrethin e Tarantos.

[Përktheu G. Capparelli - Malcori]

Dott. Pasquale De Sue

Shëmbëlltyra e gruas

2.1 Gratë nëpër botë dhe nëpër kohë

Të shkruash rreth gravet nuk është kollaj, shumë bojë ka rrjedhur për të rrëfyer vendosmërinë e tyre për të rifituar vendin që u takon në botë. Sot, pas një procesi të gjatë, gratë kanë arritur emancipimin nëpërmjet barazisë juridike dhe politike.

Gjatë rrjedhën e shekujve, burri, me karakterin e tij mbisundues, ka gjithmonë kërkuar të zhdukë zërin e gruas, dhe, shumë herë, ka shkelur dinjitetin e saj; dhe kjo është aq e vërtetë sa, historikisht, e kaluara paraqet gruan si një qenie që jetonte një gjendje, shoqërore – ekonomike dhe politike, poshtëruese pabarazie, e angazhuar në një luftë për të rifituar barazinë e të drejtave njerëzore, të drejta të ruajtura vetëm për botën mashkullore.

Gratë shikoheshin si pajisje, të nënshtruara vullnetit të atit ose të burrit, dhe vlerësoheshin si qenie të prapambetura dhe me pak zgjuarsis; ishte e pamundur, dhe nuk merrej dot me mend, të mendoje gruan jashtë rrethit shtëpijak, dhe brenda të cilit veprimtaria e tyre ishte tepër e kufizuar, merreshin vetëm me qeverisjen e shtëpisë dhe me edukimin e fëmijëve. Për sa i përket të drejtave politike, nuk u lejohet pjesëmarrja në zgjedhje, nuk gëzonin asnjë të drejtë mbi pronën, mbi të drejtën e studimeve, mbi të drejtën e punës, dhe nuk u lejohej ndarja nga burrat, sepse me ta ishin të lidhura nga një marrëveshje të heshtur besnikërie të përjetshme. Nuk bënte përjashtim pozita e tyre për sa i përket fushës ekonomike, puna e gruas, kur nuk ndalohej ose nuk shpërnohej, shpërblehej shumë më pak sesa puna e burrit. Të vlerësuara si njerëz të dobët, gratë, kur nuk ishin të shfrytëzuar, ishin të shtyra të ktheheshin në vendin e tyre natyror, shtëpia. Po të pranoheshin si punëtore, puna e tyre do të shtonte numrin e mundshëm të konkurruesve në fushën e punës.

Ndjekja e të drejtave shoqërore, ekonomike, qytetare dhe politike nuk ka qenë punë e lehtë, sepse pengesa më e madhe që duhej kapëcyer ishte simbolizuar nga gratë vetë, ato, që gjatë shekujve u është mohuar e drejta e mendimit dhe të arsyetimit, nuk kanë kurrë vlerësuar mundësinë për t'u bashkuar në të njëjtën ndërgjegje e përbashët e cila mund t'i afronte dhe t'i drejtonte kah fitimi i lirisë vetjake.

Me punë të madhe, gjatë kohës, zëra të vetmuar të grave të ndërgjegjshme morën fuqi, duke u bërë njëzëshmëria e shoqatave, këshillave, e bashkimeve femërore që kanë ngritur (dhe ngrenë) çështjen e emancipimit femëror, emancipim deri atëherëshëm i shtypur nga një sistem ligjor kufizues, nga zakone të prapambetura, dhe nga juridiksioni i vjetër. Lipsej patjetër një ndërrim në rrjedhën e ngjarjeve, për të mirën e grave, të fëmijëve të tyre dhe për mbarë njerëzimin.

Në veçanti, duke shqyrtuar realitetin italian, gjendja e gruas fillon të përmirësohet aty, nga gjysma e shekullit XX, kur gratë fituan të drejtën e votit me anë të Lëvizjes Femërore (lëvizje që lindi në Angli në fillim të shekullit 1900); të cilat ngadalësuan veprimtarinë e tyre vetëm kur arritën fitorën e plotë (1946), për t'u rrigjallëruar me zell të ri në fillim të viteve gjashtëdhjetë. Vite këto të karakterizuara nga një lëvizje për rivendikimin e të drejtave të familjes, të punës e të shoqërisë.

Në përgjithësi, duke u nisur nga paslufta e dytë erdhi duke marrë forcë një ide autoritare të jetës, e karakterizuar nga luftëra dhe veprime mosbindjesh civile për t'u vendosur barazia e vërtetë dhe jo sa për t'u dukur midis gruas e burrit. Me fjalë të tjera, qëllimi ishte për të fituar të drejta të reja, për një pjesëmarrje në jetën politike të grave, për arritjen dhe njohjen të grupeve dhe organeve femërore për të fituar objekte si: e drejta e shkurorëzimit (1970), barazia bashkëshortore dhe bashkëpronësia martesore (1975), njohja ligjore e dështimit (1977), barazimi i mësimave shkollorë, të njëjtat si për vajzat ashtu dhe për djemtë. Në këtë skenë ndërrimi të plotë, futën, me pak vonesë, shfuqizimi i ligjeve që deri atëherë kishin krijuar dallime midis grave e burrave, si ai që pëfshinte midis "Krimeve kundër moalit" edhe përdhunimin e incestin, binte, më në fund (1990) ligji që nuk lejonte hyrjen e grave në forcat e armatosura. Qëllimi i përgjithshëm i grave ishte, pra, ai t'i përputheshin idesë se ishte e domosdoshme ecja e tyre pranë burrave për të marrë pjesë në zhvillimin dhe mirëqenien e shoqërisë. Barazia aq e kërkuar dhe aq e dëshiruar midis burrit e gruas është një koncept i nevojshëm, por të kundërshtosh biodiversitetin midis burrë e grua, si qenie të ndryshme nga natyra, është i paarsyeshëm. Kjo larmi, e vendosur nga një qenie e epërme, u cakton, për forcë madhore, disa pjesë njerit dhe disa pjesë tjetrit. Për këtë arsye gratë nuk duhet të gabojnë, duke kërkuar me çdo kusht ngjashmërinë e plotë me burrin, ose deri ta zëvendësojnë atë, domethënë përmbysjen e rolëve. Huqi i gruas për të tejkaluar vetveten duke mposhtur burrin, i jep asaj një shëmbëllim të ndryshëm nga ai i caktuar nga historia: mbartëse e parimeve të gjithësisht dhe të shëndosha. Një grua pothuajse e çinteresuara që i zhduket nga sytë qëllimi kryesor të theksojë identitetin e vet pa mohuar rolin e saj.

Roli kryesor në shoqërinë femërore nuk gëzon një vlerësim real të mjaftueshëm megjithëse gruaja mundohet të jetë një grua e suksesshme, e cila me këmbëngulje ndjekë udhën e zgjedhur. Ky sepse, matanë realizimit vetjak, gruaja vazhdon të jetë e trajtuar si një mall. Për të vërtetuar kaq, mjafton të shikohet televizioni, dhe menjëherë të bie në sy, për shembull, industria e reklamës që të paraqet gruan si një i thjeshtë objekt seksual; fusha e modës e ngre atë si një Afërditë të heshtur; lëmi i artit i rezervon të njëjtin tekst që i rezervon një këngëtare o valltare të thjeshtë. Pa dyshim se kundrejt këtij realiteti ekziston një tjetër, i cili është diametralisht i kundërt, por emulohet shpesh e me gjithë qejf ngaherë i pari.

Duke vazhduar të trajtojmë barazinë midis dy gjinive, është interesant të vihet në dukje si *World Economic Forum*, nëpërmjet hetimit të *Global Gender Gap Index*, na bën të ditur se Italia, duke iu referuar vitit 2010, ndodhet në vendin 74, midis 127 Shtete që marrin pjesë në shqyrtim. Ky hetim, gjithashtu, na vë në dijeni se numri i grave të regjistruara në shkollë të mesme, të lartë si edhe në shkollën e lartë (aty ku gratë parapëlqejnë më shumë fakultet klasike, artistike dhe mjekësore, pavarësisht se këto profesione ofrojnë fitime të ulëta), është rritur jashtë mase. Dhe është aq e vërtetë sa në administratën publike gratë përbëjnë shumicën (njafton, këtu, të numërosh nësueset e shkollës). Me kënaqësi të madhe, hetimi i sipërmendur na vë në dukje se, për sa i përket tregut të punës, grave janë shtuar mundësitë dhe kushtët lehtësuese për t'u punësuar, pavarësisht se rrogat janë mesatarisht më të ulëta se rrogat që marrin burrat. Kësaj gjendje i kundërvihen po aq pasoja të këqija, si përqindja e lartë papunësie femërore (sidomos në Italinë e Jugut); përqindja e ulët punësimi femëror, si rrjedhim të mosveprimit të gruas për shkaqe të lidhura me mbarëvajtjen e familjes (si p. sh. amësia). Mosveprim që nuk u kthen grave kohë të lirë për të pushuar o për t'u dëfryer, por, përkundrazi, shtohet angazhimi i tyre në punët e shtëpisë (punë shtëpiake, gatimi, pastrimi, larja e rrobave, dhe kujdesi për fëmijët dhe për pleqtë që bashkëjetojnë në gjirin e familjes), duke nënvizuar se bashkëshortët e tyre janë pak të interesuar kësaj gjendje. Me fjalë të tjera, mund të themi se puna shtëpiake e çifteve mbetet mbi kurrizin e grave, duke përfunduar se këto, gratë, punojnë më shumë se bashkëshortët e tyre. Më në fund, sipas hetimit të sipërpërmendur, përqindja e grave që merr pjesë në jetën politike italiane është shumë më e ulët se ajo e burrave.

Sot e kësaj dite, ne jetojmë në një Itali ku tregu dhe shoqëria janë duke marrë përmasa globale, ku logjika e shpërndarjes së pasurisë, e grumbullimit të kapitalit, dhe të prodhimit duhet të ishin motori i zhvillimit. Argumentime të tilla mund të realizohen, në sistemin e tanishëm ekonomik, me punën, e cila krijon paranë e rrjedhimisht begatinë. Si pasojë, paraja përcakton pavarësinë tipike dhe të jepë mundësinë për të bërë disa zgjedhje vetjake. Sot, kundruall krizës ekonomike, krizës së punësimit, dhe rrjedhimisht rënies shoqërore vihen në rrezik pikërisht ato zgjedhje vetjake, dhe ajo pavarësi, dhe në një skenar të tillë dëmtohen kryesisht njerëzit e dobët të zonave të prapambetura: konkretisht, gratë e Jugut.

Këtu, kjo gjendje e vështirë krijoi rrethana vuajtjesh shoqërore të rënda. Për të kuptuar rëndësinë e ndryshimeve që po jetojmë, duhet të vihen në dukje dritëhijet e kësaj zonë të larmishme, tokë me pabarazi shoqërore të theksuara, dhe jo vetëm, por edhe me pabarazi truallsore, por të dyja të dëmshme për gratë tona. Ajo që bie në sy është se këto vajza, të cilat kanë pasur besim të madhë dhe kanë derdhur mjete për të përshkuar një rrugë formimi dhe njohurish, u bënë, për këto troje, kapital njerëzor. Por përballë krizës, ato ndodhën përpara një paradoksi të papëlqyeshëm: ato janë majat më të përparuara të modernizimit të Jugut, dhe njëkohësisht viktimat e caktuara të një

shoqërie të palëvizshme dhe të padrejtë që nuk ka shoqen, e cila shoqëri, përfundon duke i shfrytëzuar në mënyrë jo të plot, ose i lë jashtë fare. Përjashtim, që në shumicën e rasteve, i shtye të kërkojnë punë të parregullta që karakterizojnë ekonominë e fshehura (d.m.th. që veprojnë jashtë ligjit, jashtë kontrollit shtetëror), ose i shtye të kërkojnë punë me raste, nëpërmjet udhëgjysmëzyrtare duke parapëlqyer edhe akrobllëkun. Për këto arsye, nuk ka përse të çuditemi, nëse, në goxha raste, gra e burra bëhen viktimë të mundshme të zhvatjeve të kriminalitetit të organizuar si edhe të ekonomisë mafioze.

Pazotësia e sistemit prodhues, qoftë për mungesë mundësie për punë të kualifikuara, për të punësuar gratë, në përgjithësi u shton prirjen papunësisë dhe amullisë. Ndikimi energjik i kësaj gjendje mbi segmentin femëror lind procese demoralizuese, procese që i kthejnë shoqërisë së jugut përqindje të ulëta grash të punësuar, pavarësisht nga nivele shumë të larta shkollimi. Ana negative e kësaj gjendje është që gratë arsimohen për të mbetur në shtëpi, ose për të marrë rrugën e kurbetit. Prandaj, kurbeti, përqindje të larta vdekjesh, përqindje të ulëta lindjesh, janë armiqtë më të këqijë të tokës sonë, të cilët karakterizojnë shkretimin dhe vjetrimin (plakjen) e katundeve. Patjetër që këtu ka disa arsye që të bëjnë të mendosh që niveli i ulët i punës dhe i punësimit të grave janë shkaktarët vendimtar të varfërisë dhe të prapambetjes së Jugut. Në çastin historik që po jetojmë, gratë e tokës sonë nëse zgjedhin të qëndrojnë në shtëpi, në pritje për një vend pune, ose nëse zgjedhin të marrin rrugën e mërgimit, sidoqoftë ato shkaktojnë një mori pasojash të papërballueshme për tokën tonë. Duke shqyrtuar gjendjen e parë, kuptimi menjëherë se kemi përballë një grua e cila shpreson se do të gjendet dikush (një burrë) që të marrë përsipër problemet e saj. E gjithë kjo nuk tregon gjë tjetër veçse vazhdimin e traditës familjare jugore, e cila mbështetet mbi një kryefamiljar, i cili, dhe vetëm ai, garanton mjetet financiare për gjithë familjen, dhe në rolet shoqërore rreptësisht të ndara midis grave e burrave. Në veçanti, funksioni i gruas kufizohet në atë hapësirë tipike e brezave të kaluar: një rol shtëpiak sipas tipit shoqëror tradicional të rritjes së fëmijës e të kujdesit për të moshuarit. Në një realitet të tillë, fusha e punës së shpërblyer nuk ka vend për gruan, sepse të dyja gjërat faktikisht pengojnë ose vonojnë lirinë e guras për të patur fëmijë, sidoms kur mungojnë shërbimet shoqërore për të miturit, ose kur mungojnë brenda shtëpisë familjare që mund të kujdesen për fëmijët, kushte këto të domosdoshme për gruan që do të pajtojë punë dhe familje.

Ndërsa, duke shqyrtuar gjendjen e dytë, gra që marrin rrugën e mërgimit, bie menjëherë në sy natura e ndryshme të rrymës shtetëtare, duke e krahasuar me ato të viteve gjashtëdhjetë. Në të vërtetë mërgimi i viteve gjashtëdhjetë karakterizohet nga pjesëmarrja masive e grave (pothuajse 50%), dhe në disa realitete truallsore, ato përbënin shumicën. Rruga e mërgimit nuk është kurrë pa dhembje, por mungesa e punës, shpeshherë mungesa e harmonisë midis titullit akademik e pozita

profesionale, jetesa plot vuajtje, shtyen të rejat, mbasi kanë analizuar të gjitha mundësitë, të marrin rrugën e ikjes. Lënë, kështu, truallin e zanafillës të bindura që do të jetë një rrugë pa kthim.

Me sa thamë deri këtu, del në shesh që shëmtirat e sistemit rëndojnë më shumë mbi gratë, dhe kjo gjë shkakton pasoje rreth anës vetjake, shoqërore, demografike dhe shton varfërinë. Është e ditur që, po të paksohen njerëzit me rrogë, vetvetiu shtohet numri i të tjerëve që do të jetojnë me të ardhurat e të parëve, kështu që familja, në mënyrë strukturore, dobësohet, dhe në një kontekst krize si kjo që po jetojmë, shtohet rrëziku i një varfërie të madhe.

Në qoftë se këtyre kushteve ekonomike që ndikojnë thellësisht përbërjen shoqërore, shtojmë mërgimin, pakësimin e imigrimit (të ardhurit nuk kanë përse të qëndrojnë në troje që nuk u ofrojnë asgjë), dhe rënien e menjëhershme të lindjeve, Jugu do të pësojë një të pashmangshëm dhe rrënjor ndryshim demografik. Ndryshim që do të ketë ndikim mbi zakonet e mbi prirjet kulturore tashmë të ngulitura në vend. Në këtë tablo apokaliptike, e përbërë nga shumë hije, ndalohej zbulimi i dritave që mund ta ndriçojnë. U referohet vetëm veprimeve të gjithave atyre grave, ose grupeve me gra që mendojnë që është i mundur ndryshimi i gjendjes. Mjafton, këtu, të mendosh sa e sa gra janë të angazhuara në luftë kundër kriminalitetit të organizuar, kundër shembjes dhe kundër korrupsionit; sa gra ndërmarrin rrugën e sipërmarrjeve duke vendosur të qëndrojnë në truallin e vet të zanafillës, duke ndihmuar, kështu, me ato forca që kanë, zhvillimin e vendit; sa gra zotohen për të shembur pengesa konvencionale; sa gra bashkohen në grari duke luftuar kundër keqtrajtimit dhe kundër dhunës mbi grave.

Mundimet e grave për të arritur qëllimet e caktuara dëshmojnë, pavarësisht nga përshtatshmëria dhe nga shkathtësia, që barazia shoqërore për gëzimin e të drejtave dhe të detyrave ende nuk u arrit; pabarëzia shoqërore midis burrave e grave është një çështje e hapur. Në ngjarjet kombëtare si edhe vendore nuk munguan kurrë gratë arbëreshe (vashzat).

Të flasësh për rolin që Vashzat zënë brenda shoqërisë, dhe në veçanti brenda tri katundeve të Arbërisë së Parkut Kombëtar të Pulinit (Ungra, Ferma dhe Firmoza), domethënë të ngarkosh ato me dritat dhe hijet për të cilat kemi folur deri këtu. Duhet pranuar që ato jetojnë një realitet tjetër, realitet që është formuar pikërisht aty ku ndeshen dy botë të ndryshme të cilat krijojnë fërkime dhe konflikte midis tyre; njëra, për të cilën kemi biseduar gjerësisht, është bota e modernizmit me gjërat, simbolet dhe mitet e vet, dhe, në veçanti, emancipimi i penguar fuqimisht nga varfëria shoqërore dhe nga ngushtësia e mundësive të punësimit dhe të pjesëmarrjes në jetën publike; kurse, e dyta është bota e traditës e trashëguar brez pas brezi që ende është gjallë me mitet e vet, ngushtësisht lidhur me historinë e Arbërisë.

Gjatë jetës së tyre, Vashzat përpunojnë të vjetrin dhe të renë, dhe shpeshherë arrijnë në përfundime deri atëherë të panjohura, origjinale, dhe magjepsë për të cilat do të kemi mundësi të flasim gjatë

këtij shkrimi. Me fjalë të tjera, do të kemi mundësinë, në vazhdim, të kuptojmë më mirë gjendjen femërore të vështirë, e cila është e pasur kujtimesh dhe dëshirash.

Vashzat, duke jetuar midis halleve të jetës dhe të shqetësimeve kulturore të së tashmës, janë në kërkim të pareshtur për të gjetur urtësi të reja, të cilat mund të shndërrojnë identitetin e tyre në një pikëmbështetje. Ndryshe nga gratë të tjera të Italisë, këto që popullojnë Jugun, kanë mundësi të gjejnë levën për të ngrerë globin, për hir të asaj kulture që i karakterizon. Duke vlerësuar të qenët ndryshe nga të tjerët, ku “ndryshe” nuk domethënë doemos “i dobët”, mund të fillohet një tjetër lloj përparimi dhe zhvillimi. Nëpërmjet mjeteve të fuqishme komunikimi, të cilat shkurtojnë largësitë dhe pakësojnë kohën, mund të hapën rrugë të reja që të çojnë drejt në një tjetër formë emancipimi pa mohuar veçorinë e vet: të qenies grua dhe arbëreshe njëkohësisht. Vetëdja aktive të jesh dhe të mbetesh “tjetër” është një kusht paraprak themelor për të zhvilluar forcat e domosdoshme dhe për të arritur të vendosesh në mënyrë të thërthortë kundrejt botës që gjithmonë i ka sunduar.

Përpara krizës së tanishme, mund të pohomi se zhvillimi global i pandërprerë është shkak i fatkeqësive të vet. Nuk bën përjashtim, këtu, prapambetja e disa zonave periferike si tonat, të shtyra drejt një procesi varfërimi material dhe kulturor.

Pikërisht këtu që vashzat duhet të fillojnë lojën e tyre. Ato duhet të japin nxitje modeleve jetese dhe shoqërore të hareshme dhe të hapura, të afta të vënë në lojë marrëdhënie sunduese midis homologimit dhe ndryshimit, midis sasisë dhe cilësisë, si edhe midis gjinisë mashkullore dhe femërore. Modele jetese, dhe shoqëri të krijuara për t’u bërë një lloj letre turnësoli që tregon cilësinë e të “riut”.

Një gjuhë “ndryshe”, një rit fetar greko-bizantin, veshje të traditës të çmuara, qoftë ato të trashëguara, ose të krijuara enkas nga rrobaqepsi artizanale, të thënat, besimet, këngët, muzikat, vallet, traditat, arti i kuzhinës etj., janë pasuri materiale që mund të shumëzohen dhe ekonomikisht të vlerësohen, dhe ato përfaqësojnë një thesar mirësie kulturore të rëndësishme për gjithë vendin.

Pakicat gjuhësore arbëreshe kanë përvetësuar, në përgjithësi, si të rrënjosen dhe si të ruhen vetvetiu, prandaj kush ka ditur të mbrohej nga homologimi, nga përshtatja dhe nga zhdukja ka sot të gjitha veglat e afta për të vërë në dyshim atë “përparim” të thërthortë rreth të cilit kemi biseduar deri tani, me vetëdijen se është mbartës i “një tjetër” e pavarur lloj rritje.

Krijueset e vërteta të këtij revolucioni janë gratë: Vashzat.

[Përktheu G. Capparelli - Malcori]

Dott.ssa Giovanna Capparelli

Gjuha folur nga arbëreshët

3.1 L'ABËRISHT

Gjuha folur nga arbëreshët është arbërishtja, me prejardhje nga toskrishtja, dialekt jugor të shqipes. Në disa katunde është përzier me thekse marr nga gegërishtja, dialekti i veriut të Shqipërisë, me greqishtjen e vjetër dhe me dialektet jugorë dal gjatë mbetjes në Itali. Ajo arbëreshe përket grupit pakicave me ngulim të vjetër që s'kanë afërsi territoriale me gjuhën prejardhje; është, në fakt, një ishull gjuhësor me traditë të vjetër, që trashëgoi, pas shekujve, dhe për të shumtën me gojë, trashëgiminë gjuhësore, kulturore dhe fetare. Sot, edhe që gjuha e sotme standarde e Shqipërisë vjen pothuajse tërësisht nga gjuha e jugut, toskrishtja, arbërishtja nuk është kuptuar plotësisht nga një shqiptar, për tehkset dhe tingujt që ndryshojnë, por është një mirëkuptim reciprok të mjaftueshëm. Në përgjithësi duket se niveli i mirëkuptimit gjuhësor midis arbëreshë dhe shqiptarë është i mjaftueshëm. Duket se 45% të fjalëve abëreshe janë të njëjtat në gjuhën shqipe dhe që njëzet 15% është bërë nga neologjizma krijuar nga shkrimtarë arbëreshë dhe pra kaluar në gjuhën e folur; të tjerat vijnë nga ndyrja me italishtjen por sidomos nga dialektet afër kaundëvet e jugut të Italisë. Njëra ndër karakteristikat tipike të gjuhës arbëreshe është mungesa e fjalëve për emërtimin e mendimeve abstraktë, zëvendësuar gjatë shekujve nga perifraza ose nga huazime nga gjuha italiane, dhe më pak, nga greqizma ose huazime në përgjithësi. Të folmet arbëreshe, megjithëse ruajnë në strukturën fonetike, morfosintaktike dhe leksikore e tyre karakteristika të përbashkëta, kanë ndryshime të mëdha në çdo katund. Fragmentimi territorial natyrisht skaliti mbi tiparit gjuhësor dhe mbi karakteristikave shoqo-gjuhësore të katundeve arbëreshë, edhe për marrëdhëniet, megjithëse të ralla në kohat e shkuara, me llojat e dialekteve italo-romane, duke futur kështu elemente huazimi të ndryshëm për çdo katund. Nuk ekziston një strukturë zyrtare politike, kulturore dhe administruese që përfaqëson katundet arbëreshë. Duhet të vëhet në dukje rolin bashkërenditje institucional bërë gjatë viteve nga provinçat me prani arbëreshe e jugut italian, të parat ato të Kosenxës dhe Palermot, të cilat krijuan Asesorate për pakicat gjuhësore përkatse. Gjuha arbëreshe nga 1999 është plotësisht njohur nga Shetti Italian si “gjuhë pakicje etnike dhe gjuhësore”. Sot është ndikuar shumë nga dialektet e vendit dhe nga leksiku italian. Disa shoqata e ruajnë dhe e vlerësojnë ndaj radios private dhe gazeta të vendit. Statutet krahinorë të Mulizit, të Bazillikatës, të Kalllbrisë dhe të Sicilisë bëjnë referim gjuhës dhe traditës greko-arbëreshe ndaj studimit ndër universitetet, megjithatë arbëreshët edhe sot ndiejnë mbetjen kulturore e tyre e kërcënuar.

3.2 TRADITA GJUHËSORE DHE LETËRSIA

Historia e pakicës arbëreshe ka karakteristika të veçanta dhe, në shumë aspekte të vetëm, në krahasim me traditat gjuhësore-letrare e të tjerave pakica pranueshëm në Itali. Lidhja e arbëreshe me të tjerat tradita gjuhësore arbëreshe, pranueshëm në të njëjten Shqipëri dhe në zona të tjera të Evropës, është pjesmarrje aktive dhe themelore në lindje e shkuar dhe letrare shqipe, kështu se si na njohmi sot. Patjetër, katundet arbëreshë kanë mbajtur një lidhje të ngushtë të brendshme me gjuhën dhe zakonet. Ndjenja përkatëse një komuniteti më imadhe, edhe me fe dhe zakone ndryshe, që përforcuar para të gjithave nga afërsia gjuhësore. Tradita gjuhësore-letrare arbëreshe lidhet me historinë e gjuhës shqipe pa karakteristika të tjera. Nuk është një lidhje sundimi gjerarkik midis gjuhës folur nga arbëreshët dhe gjuhës shqipe. Më se një lidhje birëzimi, dhe vartësie, duhet të flitet në mënyrë korrekte traditje paralele dhe e barabarte, që ndan për një priudhë të gjatë me të tjerat tradita kulturore arbëreshfolëse shumë aspekte të zhvillimit të gjuhës, të letërsisë dhe, nga ana tjetër, natyrisht, dallohet për aspekte lidhur me veçoritë e vendit, e organizimit shoqëror, ekonomik dhe juridik specifike të çdo vendi. Shkrimtarët dhe poetët arbëreshë morën pjesë në lindje dhe zhvillimin e letërsisë shqipe. Aq për përmbajtjet aq për vlerën poetike, autorët arbëreshë, dalin me një rëndësi të madhe në gjithë historinë e letërsisë së Republikës Shqiptare. Për më tepër të folmet arbëreshe patën edhe një rol pasurimi të madh të leksikut të gjuhës letrare shqiptare, me një prodhim të shkruar të rëndësishëm, me të cilin fillon tradita letrare në gjuhën shqipe.

3.3 RUAJTJA E GJUHËS

Të drejtat e pakicës etnike dhe gjuhësore arbëreshe janë njohur në tekstet ligjore në bazë të institucionave kombëtare dhe ndërkombëtare (Unesco, Bashkimi Evropian, Këshilli Evropian, Kushtetuta Italiane dhe pra ndër Krahinat). Duke zbatuar nenin 6 e Kushtetutes dhe në përputhje me parimet e përgjithshme vendosur nga organizmat evropjanë dhe ndërkombëtarë, Republika Italiane ruan, vlerëson dhe niton pasurinë gjuhësore dhe kulturore e popullatave arbëreshe. Nga 1999, me ligjin 482 të 15 dhjetor, “Norma mbrojtje të pakicave gjuhësore historike”, ruhen pakicat etnike dhe gjuhësore pranishme në territorin italian, ndër të cilat ajo arbëreshe. Kur pakicat gjuhësore, cituar në nenin 2, janë në territore provinçale ose krahinore të ndryshme, ato mund të themelojnë organizme bashkërenditje.

Dott. Capparelli Domenico

3.4 ROLI I GRAVET NË RUAJTJEN E GJUHËS

Syrgjynosur në një rol shtëpjak gratë arbëreshe kanë dhe patën një rol identitar themelor. Megjithëse koha donte gruan në një vend anësor në jetën shqiptare dhe arbëreshe dhe megjithëse në vendosje e nënshtruar, në fakt kurrë nuk qe kështu.

Në drejtësinë zakonore shqiptare guaja nuk kishe fuqinë të trashëgonte të mirat, në fakt trashëgimia e të mirave të familjes bëhte ekskluzivisht nga ana e burrave. Vajza e martuar bëhte pasuri dhe forcë pune për familjen e burrit, domethënë nusja ishte një grua shtëpiake pjellore, e afte për kujdesën e fëmijës, e burrave të shtëpisë dhe të të njëjtës shtëpi; ishte edhe ajo që në arë kishte të pononte në ata ara që më parë ishin punuar nga vjehrra. Shumë janë referimet në letërsi që tregojn si në kohën e kaluar kjo ishte e zakonshme.

Në shoqërinë arbëreshe gratë patën një rol themelor, njëkohësisht të fuqishme dhe të vullnetshme. Botimet e fundit kanë dëftuar një numër të rëndësishëm grash arbëreshe që morën pjesë aktivisht tek komplotet dhe tek lëvizjet e Risorxhimento-s italian. Në të treguar ngjarjet personale që lidhen me historinë kombëtare hartueset e botimit zbuluan njëzet e pesë, ky është numri e atyre për të cilat patën lajme por kushedi sa janë ato për të cilat u humbën gjurmat. Gratë e Rosorxhimento-s për të cilat flitet janë njëzet e pesë kemi thënë, midis tyre tri janë gra arbëreshe, tri gra nga Ungra: Maria Cucci, Lucia Irianni e Matilde Mantile.

Referimi këtyre grave guximtare mund të duket që del nga tema e këtij artikulli të shkurtër, në të vërtetën provon edhe një herë si ngulmi i ngavet arbëreshe është forcë lëvizëse dhe forcë ngjitëse të gjitonisë, regjistare e shoqërisë dhe rojtare e vatrës.

I pari hap drejt ndërtimit e jetës së saj ishte martesja; kur gjente një djalë që nuk ishte të katundit e vet ose që fliste italisht përgjegjësia e kalimit të gjuhës vinte eksklusivisht nga gruaja; kur ishte gruaja që fliste italishtjen rreziku e mungesës së kalimit të gjuhës ishte shumë i lartë. Sot rreziku është edhe më i lartë. Nga njëra anë gjuha është lënduar nga forca e gjuhës sunduese, nga ana tjetër mungon funksioni i gjitonisë që ruante fëmijën gjatë orave pune të grave dhe që ishte e mësues për fëmijën që s'kishte nënën arbëreshfolëse.

Firmozë, pas së dytës luftë botërore, me mërgimin drejt Gjermanisë, edukimi i fëmijës ishte nënë kujdesën e grave sepse burrat niseshin të vetëm për të majtur familjen dhe për të siguruar të ardhmen artyre. Njëra ndër karakteristikat e vërtetueshme deri pak vjet prapa ishte prania e disa fjalë ekskluzivisht brenda gjuhës e njerës familje ose e njëtrës familje, mund të vendoste kështu përkatësia e një anëtari vetëm nga përdorimi e disa fjalë.

Gjithëmonë në jetën shtëpjake dhe lidhur me edukimin e fëmijës duhet të mbahet para sysh funksioni i përrallave, trillimave, parambotave dhe ninananave. Këto janë lidhur ngusht me ndjenjat e nënës që shpreh me fjalë vet të saja dashurinë për fëmijën. Struktura dhe tregimi janë fiks por

fjalët dhe muzika e vargjeve marrën një fuqi komunikative e madhe; kjo ndodh më shumë në parambota dhe ninanana në të cilat përdoret një gjuhë e qartë, e thjeshtë që adaptohet theshtësisht muzikës së parambotes; është nëna që zgjedh fjalët më të afta, ato më më shprehse dhe kuptueshme; është nëna që merret të zgjedh fjalë që nuk lënë kuptimin në fjali të vështirë, përdor rregullisht pauza në fund të çdo vargu dhe zgjedh fjalë që duhet të jenë të ëmbla për veshën e fëmijës.

Jeta e gravet nuk ishte vet syrgjynosur në jetën e familjes kështu puna në arë ishte një çast bashkimi përveç që lodhje. Gratë alternojnë punës tregime dhe këndime që u jip mundësinë atyre të lehtësojnë peshën e punës. Me qenë se puna në arë ishte pothuajse për gjithë mjet mbajtëse dhe me qenë se merrte punuesit për pothuajse gjithë vitin, bëhte si e dyta familje me të cilën mbështeteshin edhe çastet çlodhje, pushimet nga puna ishin arsye bashkimi. Janë ndër këngat pune Ajiret, kënga polifonie kënduar nga një zë kryesore të cilës bën jeh një kor me shumë zë; ndër ato edhe sot të kënduara: Ajiri kallamesë, Ajiri dhomatavet, Ajiri i ullinjvet.

Aktivitete deri këtu treguar, megjithëse zbatuar më shumë nga gratë, ndërlikojnë edhe burrat; por ishinin disa gjëra zbatuar vetëm nga gratë. Në traditën arbëreshe gratë këndojnë disa kënga popullore por pranuar dhe njohur nga kisha, janë Kalimerat. Këto kënga ndrojnë për çdo katund, vetëm një këngë është e njëjta për shumë katunde është ajo që tregon Vuajtjen e Krishtit.

Është ndër praktikat pothuajse magjike Racjuna. Është një llojë parambote që nuk mund dhe nuk duhet të jetë thënë gjithëve. Funkzioni i saj është të hiqet e keqa, ajo që e njeh lyp njerinjvet që kanë të ligat një gjë personale me përdorim ditar dhe që do të jetë mjet lidhëse midis tyre. Racjuna mund të trashëgohet vet në dy ditë të vitit: Vigjilia e Krishtlindjes dhe dita e Pashkëve.

Shoqëronin në udhëtimin e fundit Vajtimet; kënga të përmortshme kënduar zakonisht nga vejushat. Disa thonë që ishinin vetëm vajtime, dikush tjetër thot që ishinin tregimi i karakteristikave ose të vlerat të burrit të vdekur.

Në fund, shumë janë pikëpamjet për të cilat gruaja arbëreshe është element ruajtje e kulturës sonë, nga shoqëria, deri në veshjet, në kuzhinën; nga lindja e saj ka një rol themelor për mbetjen gjallë e popullit arbëresh.

Dott.ssa Bavasso Saverina

4

Riti

4.1 Hyrje

Në këtë kapitull do të flasim për një nga pamjet e traditës që arbëreshët kanë ruajtur me merak të madh: ritin fetar. Pa u zgjatur shumë, do të shpjegojmë shprehjen e adhurimit më të lartë të krishterë, qoftë nga pamja e traditës lindore ashtu edhe nga pamja e asaj perëndimore, domethënë Liturgjia Hyjnore greke, dhe Mesha e Shenjtë latine. Ende sot e kësaj dite, në shumicën e bashkësive arbëreshe ruhet gjallë riti greko-bizantin. Gratë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe në kalimin brez pas brezi të ritit, një nga shenjat dalluese të pakicës sonë etno-gjuhësore. Që nga fillimet, përveç ruajtjes së rregullit, dhe të zbukurimit të kishave (shpesh me lule), ato që kanë mbushur ndenjëset e kishave tona kanë qenë zakonisht gratë; gra që, gjatë shërbesave fetare, këndojnë Liturgjinë Hyjnore në greqishtën e lashtë. Besimtare të palodhura që kalojnë brez pas brezi, ndoshta në mënyrë të pavetëdijshme, ritin tonë. Por, veç për sa i përket trashëgimit të ritit, gratë kanë marrë pjesë në ruajtjen, gjatë kohës, e krejt këngëve paraliturgjike, pra këngë të trashëguara nga krijimtaria popullore. Këngë këto që nuk mund të quhen në mënyrë tipike fetare o liturgjike, por janë të pranuar si të tilla nga kisha. *Kalimeret* janë këngë popullore që tregojnë arbërisht pësimet e Krishtit dhe këndohen gjatë Javës së Madhe. Gratë në kontekstin fetar arrijnë të japin, pra, një ndihmesë të rrallë dhe konkrete. Kisha luan një rol thelbësor në jetën e bashkësive arbëreshe: është një pjesë përbërëse që bashkon dhe që hyn në mënyrë vendimtare në jetën e përditshme. Sot që brezat e rinj janë larguar nga kisha shkon, së pari, në dëm të një kulture të krishterë, dhe, në mënyrë të veçantë, në dëm të ritit greko-bizantin. Në këtë kapitull, veç lavdërimit të ritit greko-bizantin, do të tregojmë historinë e “Bijave të Shen Makrinës”, të “Një gruaje që jetoi si Shejte” dhe të “Një murgeshë revolucionare”.

4.2 Kisha lindore në Itali

Një nga vetitë më në zë të imigrimit në Itali, nga ana e bashkësive të tëra arbërore, përbëhet nga ruajtja e ritit greko-bizantin gjatë liturgjisë, nga priftërinjtë të vet, nga struktura hierarkike dhe nga disiplina kanunore të Kishave Lindore. Të tërheq vëmendjen shqyrtimi i parabolës që ka prurë Kishën Botërore të ndahet në një Kishë Perëndimore dhe në një Kishë Lindore e sa vështirësi kanë vuajtur arbëreshët për të ruajtur përkatësinë e Kishës së tyre Lindore në truallin italian, seli e Kishës së Perëndimit. Pjesa më e madhe të bashkësive arbëreshe, pesëdhjetë gjithsej, ruajnë edhe sot e kësaj dite ritin bizantin. Ato varën nga dy eparki: ajo e Ungrës për arbëreshët e Italisë

gadishullore, dhe ajo e Horës së Arbëreshëve për arbëreshët e Siqilisë. Këto dy eparki motra, bashkë me Manastirin Eksarkik të Grotaferrata-s i mbarështuar nga kallogjerë arbëreshë, përbëjnë Kishën Arbëreshe, realiteti më i rëndësishëm për ruajtjen e vetive fetare, etnike, gjuhësore, kulturore dhe identitetin e pakicës arbëreshe. Kisha luan një rol thelbësor në jetën e bashkësive arbëreshe: është një pjesë përbërëse që bashkon dhe që hyn në mënyrë vendimtare në jetën e përditshme. Riti liturgjik që ndjek Eparkia e Ungrës është ai Bizantin-Grek. Veçoritë me ritin latin janë potuajse të pakapshme për sa i përket lëmit teologjik, por ndryshon struktura e përbrendshme të klerit: priftërinjtë grekë, për shembull, mund të marrohen para të shugurohen dhjakë, dhe viti kishtar është i ndarë në mënyrë të veçante. Liturgja greke është e nginjur me frymë shpirtërore. Cerimonitë që të magjepsin në mënyrë të veçantë janë ritet dhe shërbesat e Javës së Madhe. Kungimi në formën e bukës dhe të verës, Martesa dhe Pagëzimi.

Arbëreshët ndjekin ritin Bizantin-Grek sepse ata janë të ardhur nga vende nën juridiksionin e Patrikut të Stambollit dhe i përkasin Kishës katolike sepse janë të bashkuar me Romën. Megjithatë janë të lidhur me Lindjen sepse kanë frymën shpirtërore, teologjinë dhe të drejtën kanunore të njëjta me Lindorët Ortodoks të ndarë nga Roma. Nga pikëpamja liturgjike dhe rregullore të gjitha Kishat ortodokse ndjekin të vetmin rit, atë të qytetit të Bizancit, nga ku ka zanafillën dhe mori emrin. Ikonat kanë një rëndësi të madhe për frymën shpirtërore të ritit Bizantin-Grek, qoftë gjatë adhurimit liturgjik, si edhe gjatë lutjeve.

4.3 Liturgjia Hyjnore

Riti fetar karakterizon bashkësit tona arbëreshe duke i dalluar nga ato italiane, mes të cilave bashkëjetojnë. Në një kohë si kjo që po jetojmë, ku, në nivele të ndryshme, u bënë përparime të mëdha gjatë udhës së mirëkuptimit të ndërsjellë si edhe të kapërcimit të mosbesimeve midis Lindorëve dhe Perëndomorëve, ia vlen, këtu, të shqyrtojmë shkurtimisht cilat janë ndryshimet midis dy riteve, me të cilat bashkësi fare pranë njëra-tjetrës shprehin të njëjtën fe; është një gjë e pakundërshtueshme që njësia e Kishës nuk varet nga njëtrajtshmëria e gjuhës, nga këngët, nga shërbesat, përkundrazi, bindemi ngaherë e më shumë që, ashtu si tregon psalmi 44, bukuria e “Nuses” varet edhe nga shumëllojshmëria e stolisjeve. Prapëseprapë, të flasësh të ndryshimeve rituale në mënyrë të plotë është një punë e rëndë. Prandaj do të shpjegojmë në mënyrë të përmbledhur shprehjen më të lartë të kultit të krishter, qoftë nga pamja e Kishës Lindore qoftë nga pamja e asaj perëndimore, pra Liturgjinë Hyjnore të Grekëve e Meshën e Shenjtë të Latinëve. Në qoftë se duhet thënë me pak fjalë cilat janë ndryshimet ekzistuese midis dy adhurimeve, mund të pohohet që nuk ekziston asnjë ndryshim, por, në mënyrë paradoksale, mund të shtohet, gjithashtu, që gjithçka është ndryshe: asnjë ndryshim për sa i përket të qenësishmes; krejtësisht ndryshe, kurse,

lutjet, këngët, lëvizjet, orendit të shenjta, simbolet. Dhe nuk mund të ishte ndryshe, meqë, duke u nisur nga i njëjti burim, tradita e pastër apostolike, dy Kishat, ajo lindore dhe ajo perëndimore, kanë zhvilluar, në mënyrë krejtësisht të pavarur, ritet e tyre, dhe njëkohësisht në vende të ndryshme për gjuhë dhe kulturë.

E qenësishmja, pra, është e njëjtë: nën simbolet e bukës dhe të verës të shuguruara, është i pranishëm Perëndia dhe Shpëtimtari ynë Jezu Krishti, i cili ripërtërin dhe përjetëson flijimjn e tij ndaj Atit: kjo është doktrina e qëndrueshme të dy Kishave. Nëse, pra, ndryshime thelbësore nuk ka, ato plotësuese, përkundrasi, janë shumë dhe të spikatshme. Ai më i rëndësishëm është që, ndërsa Mesha Latine është më e thjeshtë, e zhveshur, pothuajse më modeste e mbi të gjitha e shkurtër, Liturgjia bizantine është, përkundrazi, e pasur, madhështore dhe e gjatë. Një “*Meshë e sheshtë*” në ritin bizantin s’ka kuptim. Madje, për traditën lindore, ruajtur gjallë nëpër Kishat Ortodokse, Liturgjia Hyjnore është vetëm pika më e lartë të kremtimit të një feste, ajo paraprihet gjithmonë nga Mbrëmësorja, në mbrëmjen e pragut të së kremtes, e nga Mëngjesi në mëngjes. Katolikët me ritin bizantin italianë lavdërojnë Liturgjinë Hyjnore pa e paraprirë atë nga Shërbesa e Mëngjesit. Megjithatë, duke kujtuar bashkimin e ngushtë midis dy lavdërimeve të mëngjesit, Liturgjisë Hyjnore, në shumë kisha, i paraprin himni i Doksologjisë së Madhe, që është pikërisht himni fundor të Shërbesës së Mëngjesit. Liturgjia greke, pra, është ngaherë madhështore: krejtësisht e kënduar (veç disa lutje të fshehta që prifti thotë me zë të ulët); edhe leximet nga Shkrimi i Shenjtë këndohen; kori është një përbërës i domosdoshëm, si edhe dhjaku, kemi, dritat, procesionet. Nga ky shqyrtim i Liturgjisë greke, domethënë nga solemniteti i saj, buron në mënyrë të domosdoshme një tjetër ndryshim me Meshën latine: ajo, pra, është e vetmja mbledhje eukaristike të gjithë popullit të Perëndisë, dhe nuk është kurrë e përsëritur. Priftërinjtë grekë nuk kremtojnë kurrë tri ose katër meshë gjatë ditës, dhe pastaj një tjetër në rast vdekje, dhe një tjetër akoma në rast martesë. Madje, zakonisht, priftërinjtë ortodoksë nuk meshojnë as çdo ditë të javës. Shën Vasili, siç pohon po ai, meshoni të dielën, të mërkurën, të premten dhe të shtunën.

[Përktheu G. Capparelli - Malcori]

Papàs De Angelis Raffaele Famullitar

4.4 Motrat Baziliane “Bijat e Shën Makrinës” në Firmozë

Ishte në mbarim viti 1931, pikërisht ka qenë data 15 dhjetor, kur Kallogreja e Parë, Motra Eumelia Raparelli, bashkë me motrat Agnese Giannetto, Eugenia Pennacchio dhe me Lutësen Ersilia Lazzarini, të mbështetura dhe të inkurajuara nga bekimi i Atit Shenjtë Pio XI, erdhën Firmozë dhe hapën Shtëpinë Baziliane të Firmozës. Ishin motrat Baziliane, bijat e Shën Makrinës,

urdhri i të cilave kishte qenë themeluar ndonjë vit përpara nga Atë Nilo Borgia dhe nga Motra Macrina Raparelli, Ëma.

Ajo ditë, tashmë e largët, është ditë historike për Firmozën. Për herën e parë në të voglin katund një grup njerëzish plot fe, zell apostollik, guxim, vullnetarisht dhe falas zu vend me një qëllim të përpikët: *«me veprën dhe lutjen... Me shembullin tonë dhe me punën tonë përdëllimtare do të bashkohemi me vëllezërit tanë në shpirtin, në mendjen, në vullnetin dhe në zemrën»*. Me rrënjë të thella në frymën shpirtërore bizantine, dhe gjithashtu të hapura kah traditat më të mira kishtare të Perëndimit, motrat baziliane në Firmozë kanë jetuar, si edhe ende jetojnë, shugurimin ndaj Perëndisë në realitetin e dyanshme: soditëse dhe vepruese. Lutje dhe veprim.

Që kur kanë ardhur midis nesh, motrat baziliane kanë dhënë të gjitha forcat e tyre në përgatitjen e rinisë dhe në shërbim të varfërve, të sëmurëve dhe të moshuarve. Në përgatitjen dhe në promovimin njerëzor me anë të katekizmit dhe të gjallërimit liturgjik.

Fillimisht jeta e tyre ka qenë e vështirë: të varfëra në mes të varfërve.

Një bashkësi e re, një shtëpi e re, një vend gjeografikisht i ri, autoritete kishtare të reja nuk penguan kallogretë e porsa ardhura të organizonin menjëherë veprimtarinë e tyre.

Dymbëdhjetë ditë pas arritjes (27-12-1931) hapën punishten për pesëmbëdhjetë vajza, më 4 janar 1932 nisën kopshtin e fëmijëve me dyzetë të mitur, më 15 janar 1932 arrinte Kallogreja Ëmë, më 16 janar Hirësia e tij Imzot Giovanni Mele, gjatë Liturgjisë Hyjnore, përruronte kishzën e shtëpisë, më 10 shkurt fillonin shkollën e katekizmit me gjashtëdhjetë djem.

Në më pak se dy muaj, kishin hedhur themelet e shëndoshta të shtëpisë shpirtërore dhe materiale që motrat Baziliane, Bijat e Shën Makrinës, kanë ngritur në Firmozë.

Kujdesin e veçantë ndaj të miturve, familjeve, të moshuarve dhe të sëmurëve e gjejmë të shënuar, me shumë urtësi, nëpër ditarët e tyre.

Kushtimi i tyre ndaj të varfrit dhe ndaj pleqtë: *«Në këtë kohë kemi kërkuar të ndihmojmë të varfrit dhe pleqtë me ushqime dhe me disa pako, u munduam të lehtësojmë pak gjithë atë mjerim dhe varfëri. Pleqtë e të sëmurët kanë qenë objekti i veprimtarisë sonë. Meqenëse mjeku ishte sëmurë, vetëm për sa i përket mjekimeve dhe injeksionëve, e kemi zëvendësuar ne, kemi bërë deri njëzet injeksionë për ditë»* (2-2-1956); si edhe: *«Një plaku të vetmuar, sot, i kemi gjetur shtëpi, një shtrat, dhe vendosëm që për drekë të vijë te ne»* (1-7-1956); akoma: *«Motra Eumelia qëndroi vetëm në shtëpi, gjatë paraditës së bashku me një grua e Acione-s Katolika ndihmoi një plak që ishte mbushur me morra»* (16-5-1943).

Kujdesi ndaj familjeve: *«Kemi mbyllur kopshtin e fëmijëve me vonesë aq sa t'u jepnim mundësi nënave të tyre të mbaronin punë në bujqësi, pa u shqetësuar për bijtë e tyre»* (9-7-1940); në një faqe

tjetër: «Me lutjen, flijimin dhe fjalën kërkuam të rivendosim paqen në një familje, për të ribashkuar burrë e grua» (3-2-1958).

Dashuria ndaj fëmijëve, dëshira për të qenë të gjithë të barabartë, pa klasa shoqërore: «U mbyllën shkollat fillore. Kemi mbledhur, këtu në shtëpi, nxënëset dhe nxënësit, të parat paradite, të dytët pasdreke. Vazhdojmë t'u japim mësim, dy motra angazhohen me ta. Me qëllim që t'i kemi më pranë Kishës dhe Jezuit» (20-5-1943); ose: «Sot kemi mbyllur kopshtin me keqardhje, sepse u ndamë nga fëmijët, për ne shumë të dashur» (14-6-1956); si edhe: «Me dëshirë të nderuarit Famullitar, dhe për të hequr disa pabarazi, kemi menduar të blejmë veshjet për Kungimin e Parë të gjitha të njëllojta» (24-2-1983).

Në fillim të apostullimit të tyre në Firmozë, nuk ishte vetëm varfëria materiale që mundonte jetën e tyre. Më 1 janar 1944, lezojmë në ditarin e tyre: «Sot Komisari i katundit, kreu i partisë socialiste, nëmi kundër priftit, e rrahu si edhe e plagosi. Tellallisi në të katër anët, që sapo të ketë ngritur mirë partinë, do të bëjë që kokat e priftërinjve si edhe ato të kallogreve të fluturojnë!».

Por nuk mjaftonte trilli i një tirani vendor të ligështonte kallogretë nga veprimi i tyre. Më 10 janar 1944: «Hirësia e tij Imzot Mele shpreh dëshirën që fëmijëve të kopshtit t'u sigurohet ngrënia e drekës. U vumë në lëvizje për të gjetur ndonjë ushqim, por, kot. Nuk kishte as grurë as patate, shkurt, asgjë. Ka kohë që nuk marrim më as racionin e bukës, 100 gramë përditë, dhe të gjithë po vuajmë urinë. Çmimi i grurit është shtrenjtë, 2000 lireta për dyzet kile, dhe patatet, 20 lireta kilja, dhe nuk gjenden. Megjithatë, kemi besim të plotë në Dorën e Zotit». Katër ditë pas, më 14 janar: «Kemi filluar shërbimin e ngrënies së drekës për fëmijët...».

Gjatë viteve gjashtëdhjetë të shekullit kaluar, së bashku me priftin Vinçenzo Matrangolo, krijuan qendrën e kujdestarisë rinore, ku strehuan qindra fëmijë të ardhur nga i tërë rrethi i Kozencës si edhe nga rrethe të tjera, duke ushtruar nënërinë e tyre, duke u dhënë një përkëdelje atyre që, ndoshta, nuk e kanë pasur kurrë, duke u dhënë zemër fëmijëve që rrinin me shikimin e humbur, duke trimëruar e duke mirërritur të miturë tashmë të nisur kah rrugë të këqija, duke ndezur përsëri shpresën në zemrat e tyre dhe duke bërë që të gjejnë ngrohtësinë e familjes.

Veçse fesë së patundshme në Perëndinë, Atë, Bir dhe Shpirt i Shenjtë, e në Hyjlindësen, motrat baziliane ishin dhe janë të mbështetura nga lutja dhe nga këshillat e Ëmës së tyre që ka themeluar urdhrin, e cila duke iu drejtuar një kallogreje në vështirësi shkruante: «Mos u tremb, pse Jezui s' do të të japë një kryq më i rëndë se forcat e tua, por kryqi do të jetë ngaherë i lehtë sepse ti do ta mbartësh bashkë me Të; rri gjithmonë e gëzueshme, hiq zymtësinë e ligështimin sepse këto janë armët e përdorura nga djalli për të prishur shpirtrat».

Nga ato ditë e deri sot, vepra e motrave baziliane në Firmozë vazhdoi e pandërprerë në dobi të popullatës, të miturve të mirërritur në kopshtin e fëmijëve, të djemve të mirëpritur në shtëpitë e tyre,

dhe të rriturve të mbështetur nga sjellja e tyre. Një fushë e veçantë të misionit të motrave baziliane në Firmozë i përket vajzave të cilat, falë besimit që prindërit kanë pasur ndaj motrave, kanë ndjekur punishtet e tyre, kanë marrë pjesë në veprimtaritë shpirtërore dhe materiale, “kanë dalë përjashta shtëpive” duke u emancipuar më parë e më mirë se shumë moshatare të tyre.

Mbi çka kemi thënë, Atë Vinçenzo Matrangolo shkruante: «... Aty ku motra Makrina nguli çadrat me bijat e saj, shkretëtira që lëruar me lotët e saj, me djersën e saj dhe me mundin e saj, dhe shkretëtira lulëzoi, dhe solli ndër shpirtrat fryte me bollëk.»

[Përktheu G. Capparelli - Malcori]

Dott. Giovanni Giuseppe Capparelli

4.5 Historia e një gruae që jetoi si një shenjte

Rosa Lotito lindi në Altomonte (CS) më 8 nëntor 1905. Në festën e Paraqitjes së Jezuit në Tempull, më dy shkurt, e çuan në kishë për të marrë bekimin.

Pasi mabroi shkollën fillore, në moshën dymbëdhjetëvjeçare, shkoi si konviktoe në Kozencë për të kryer studimet e mesme, aty u shqua për sjelljen studimore dhe për disiplinën, dhe, si nbushi tetëmbëdhjetë vjeç, diplomohet. Në moshën njëzetëvjeçare sëmuret nga peritoniti: atë kohë s’bëhej fjalë për shtrim në spital, kurohet në shtëpi, me mjekime që shkaktonin dhimbje të forta e vuajtje. Gjatë sëmundjes, në çastet më të vështira, kur të afërmit kishin humbur fare shpresat, me nbështetjen dhe angazhimin e vazhdueshëm të tre mjekëve të porsa diplomuar, bashkë me ndihmën e Zotit dhe lutjet e nënës, fillon gjendja e saj të përmirësohet, dhe atëherë mjekët këshillojnë një ndërrim mjedisi për të kaluar plot periudhën e shërimit.

Familja kishte një tokë jo shumë larg nga fshati, afro një gjysmë ore rrugë, aty ishte ndërtuar një shtëpi e bukur dhe e rehatshme (dikur, në kohët e lashta, kjo pronë ishte e një çifligari në zë të katundit) ku ne u vendosëm familjarisht. Farefisi dhe miqtë shpeshherë vinin për vizitë, dhe kjo gjë ndikonte shumë në përmirësimin e motrës. Karakteristik tjetër që na kënaqte ishte dëgjimi i kabanave të kishës së Firmozës. Në këtë mjedis, ku ajri ishte i pastër dhe jeta rridhte e qetë, motra shërohet krejtësisht.

Nis ushtrimin e profesionit, ne fillim në Altomonte, si mësuese në kopshtin e fëmijëve të fshatit, pastaj, pasi fitoi me sukses të madh provimin e aftësisë për arsimtare, filloi të jepte mësim nëpër shkollat e shtetit në katundet: Koriljano, Fermë, Farneta, fshat ky fare i vogël, vetë pesëqind banorë, dhe në Montexhordano. Këtu, në Montexhordano, mbërritja e saj u prit nga të gjithë me gëzim të madh: prindër dhe nxënës i dolën përpara me tufa lulesh. Aty jepte mësim në një klasë kolektive, duke u dhënë fëmijëve me dashuri e durim të madh. Prindërit, në shenjë dashurie dhe mirënjohje, e nbushnin me dhurata.

Bashkë me një shoqe pune themeloi *l'Azione Cattolica* (shoqatë fetare); për herën e parë fëmijët i afroreshin doktrinës katolike dhe përgatiteshin për të marrë Kungimin e Parë: ishin shumë, dhe aty u shqua për virtyt dhe frymë të lartë apostolike. Ndërkohë një sëmundje tjetër filloi ta mundonte ditë dhe natë, një ulcerë në stomak; dhe për këtë arsye bën kërkesë transferimi.

Me hapjen e shkollave të vitit 1934, Rosa Lotito emërohet mësuese në shkollën e Firmozës ku punoi deri në daljen në pension.

Emërohet nga Peshkopi i Ungrës, imzot Mele, Presidente e *Azione Cattolica* e famullisë dhe e eparkisë: nuk ndihej e aftë, por pranoi detyrën, duke iu kushtuar punës me zell e me përpikëri, dhe ngaherë duke kërkuar ndihmën e Zotit. Filloi të merrte pjesë në kurset e kësaj shoqate si edhe në vetmitë shpirtërore në Paola, dhe meqenëse i përkiste një Instituti laik si Françeskane, ajo, gjithashtu, merrte pjesë edhe në vetmitë shpirtërore që mbaheshin në Assisi. Ka qenë gjithashtu edhe Presidente e A.C.M.C. (Associazione Cattolica Maestri Cattolici). Çdo muaj u dërgonte përgjegjësve qarkore që shkruante me dorë, letra që e mundonin shumë sepse nuk ishte mirë me shëndetin, dhe ky angazhim i shtoej punës si mësuese.

Këto qarkore ishin plot këshilla dhe nxitje dhe ne to dilte në pah zemërgjersia e saj, dhe, gjithashtu, letrat që merrte nga varësit ishin plot falënderime e mirënjohje.

U angazhua edhe me gratë katolike, e të rejat i bënë si dhuratë një makinë shkrimi. Në këtë kohë filloi të vizitonte edhe famullitë e eparkisë, si, për shembull: famullinë e Fermës, e Frasnitës, e Çiftit, Shën Vasilin, e Mbuzatit, e Strigarit etj., veç vizitave vazhdonte me qarkore, që tani shkruante me makinë shkrimi.

Gjatë vitit 1961 rishfaqet ulcera me dhimbje të forta, ishte në fazën e fundit. Shkon në Romë, vizitohet, dhe brenda pak kohë i nënshtrohet një ndërhyrje kirurgjikale; shpëton, dhe pas dy muajsh kthehet në shtëpi. Thoshte se Zoti i kishte shpëtuar jetën sepse kishte mbi të plane të tjera, dhe, me angazhim të ri, rifilloi punën në shkollë si edhe në *Azione Cattolica*.

Midis viteve 1970 dhe 1976 operon të dy sytë nga perdet. Gjatë vitit sëmuret me ethe të forta dhe me kollë, shërohet pas një shtrimi në spitalin e Ungrës, por, po atë vit, prapë bie sëmurë, diagnoza: sëmundje të zemrës, dobësim organik, emfizemë.

Më 1 tetor të vitit 1978 del në pension, dhe nis një punë tjetër: i kushtohet djemve të konviktit të porsa themeluar pranë famullisë së Firmozës. Ndërkohë shkruam shumë: kopion nga Shkrimet e Shenjta të gjitha ato pjesë që përbëjnë liturgjitë e festave, i boton në broshura që do të përdorin besimtarët. Çdo javë shaptilografonte fletushkën e lajmeve të famullisë (Bollettino Parrocchiale), aty shënoheshin ngjarjet e famullisë. Ka vazhduar këtë punë deri pak ditë para vdekjes. Lodhej shumë, por ishte gjithashtu e bindur që angazhimi duhej çuar deri në fund. Gjatë jetën e këtejshme ka kryer gjithmonë vullnetin e Perëndisë, ngaherë e qetë, pavarësisht nga vuajtjet që e mundonin

shumë. Ndiqte ngaherë rregulloren e saj të jetës, edhe e sëmure nuk ndjeu kurrë keqardhje ose lodhje: në orën e caktuar ishte gati të fillonte ditën e re, lutje e punë të kushtuara Perëndisë. Lutej dhe punonte pandërprerë dhe pa u lodhur, çdo çast i ditës, për të, ishte i çmuar.

Nuk u thoshte kurrë «jo» atyre që i kërkonin diçka, edhe kur ishte e qartë që sëmurdja e mundonte.

Nuk mendonte keq për asnjëri, dhe të gjithë i falte.

Në jetën e këtejshme të saj ka vuajtur tepër, jo vetëm fizikisht por edhe moralisht; fytyra e saj e qetë tregonte flijimin ndaj Zotit dhe guximin të fillonte rishtas: lutej dhe falte.

Të ardhurat e saj materiale ndihmuan familjen e vet të madhe, duke krijuar mundësinë që vëllezërit të studiojnë, dhe duke u kujdesur për nevojat e shtëpisë me dashuri amënore. Sikur ta kishte detyrë, jetën ia kushtoi tërësisht familjes. Qysh në rini ka qenë ngaherë e shkëputur nga gjërat bosh të jetës, duke u dalluar nga të tjerat shoqe.

Çdo mëngjes takimi me Jezuin, përsiatja, recitonte Mbrëmësoren dhe shërbesën e Mëngjesit, rruzaren; mundimet e Krishtit ishin buka e përditshme, që e bëjnë të qetë, të gëzueshme, të gatshme për çdo gjë, edhe për vdekje.

Më 15 prill të vitit 1981, rreth orës 10,40, në moshën shtatëdhjetegjashtëvjeçare, e qetë dhe me një buzëqeshje ndërroi jetë.

Në ata që e kanë njohur dhe i kanë qenë pranë, la një kujtim të madh, ndërsa familjes i la një dhimbje të pafundme.

[Përktheu G. Capparelli - Malcori]

Marietta Lotito, e motra.

4.5.1 Amaneti i Rosa Lotito-s

Rroftë Krishti Mbret!

Me këtë testament, shkruar nga dora ime dhe duke qenë me aftësi mendore të plota, zhvleftësoj dhe shfuqisoj çdo amanet që kam shkruar para kësaj date, dhe dua që vetëm ky të jetë i vlefshëm.

Emëroj zbatuese testamentare motrën time Marietta.

Vendos që vetëm ajo ka të drejtë të përdor letrat e mia, dhe me to të bëjë çfarë të dëshirojë.

Për sendet e mia që do të mbetën pas vdekjes sime, si: gjë e mall, të holla, veshje, libra etj., lë trashëgimtare motrën time Marietta, e cila ka të drejtën e pronës pasi plotësoi dy detyra:

- 1) të kujdeset për varrimin tim, që do të jetë i thjeshtë, dhe për përshtypjet në kujtimin tim;
- 2) të hollat që do të mbeten, të ndahen në dy pjesë të barabarta midis Marietta dhe Enrico, i cili (ky i fundit) mund të ketë vevojë meqenëse nuk ka familje të vet.

Pasi që rregullova gjërat truallsore, dëshiroj të ritheksoj dëshminë time fetare, duke shpallur se jamë e gëzuar dhe mirënjohëse ndaj Perëndisë se linda, jetova dhe vdiqa në gjirin e Kishës Katolike.

Pranoj vdekjen nga duart e Perëndisë si shenjë dënimi e mëkateve të mia, dhe për të arritur paqen e jetës dhe shenjtërimin e shpirtave.

Ju porosis vëllezër, motër, kunata, mbesa e nipër të jetoni si të krishterë të vërtetë, në paqe, duke shikuar kah qielli e jo kah toka dhe kah sendet kohëshkurtra. Duani Zotin me gjithë zemër, dhe duheni njëri-tjetrin, duke u djerë në mënyrë të ndërsjellë fyerjet e mundshme për të merituar nga Perëndia ndjesën.

Falënderoj me gjithë zemër ata që më kanë bërë të mirat, që më kanë shërbyer dhe duruar, që më kanë dashur pa marrë parasysht të metat e mia.

Veçanërisht falënderoj atë që më ka ndihmuar në përgatitjen time të krishtere dhe më ka mbështetur në jetën time shpirtërore, dhe mbi të gjitha falënderoj kush më ka korrigjuar duke bënë e vuajtur natyrën time tepër të ndjeshme, sado pamja e jashtme.

Falënderimi im do të shndërrohet në një mori lutjesh për mirëbërësit e mi, dhe do t'i lutem Zotit t'ua shpërblejë.

U kërkoi ndjesë, me gjithë zemër, kujtdo u kam shkaktuar hidhërime, zhgënjime dhe shembuj të këqij.

Ashtu siç unë ngaherë kam ndjerë dhe kam harruar çfarëdo fyerje ose hidhërime që kam marrë, dhe gjithmonë kam falur atë që ka bërë që unë të vuaja, kështu ju lutem të më falni e të më shfajësoni.

Ju lutem të më kujtoni në lutjet tuaja, dhe të ndihmoni ndonjëherë shpirtin tim të arrijë në jetën e amshueshme me ndonjë vepër bamirësie materiale si edhe shpirtërore.

Ndihmohmi të arrij sa më shpejt shtëpinë e Perëndisë, të cilit i kam kushtuar jetën time dhe shpirtin tim.

Mirupafshim në parajsë, të dashurit e mi!

Firmozë, më 27.9.1978

[Përktheu G. Capparelli - Malcori]

Rosa Lotito

4.5.2 Nga ditari i Kallogreve Baziliane – dita 15 prill 1981

Java e Madhe na sjell një të papritur të madhe: vdes zonjusha Rosa Lotito. Është e Mërkura e Madhe, prifti niset për në Kozencë bashkë me kallogretë: motrat Sofi dhe Basilia. Qysh në mëngjes, ne kemi shkuar, kur njëra e kur tjetra, për vizitë zonjushës Rosë; dukej se gjendja e saj ishte pak më mirë. Rreth orës 10 e gjysmë, duhej të shkonim në kishë për përgatitjen e altarit. Gjatë udhës, i thashë vetes: më përpara të takoj Rosën Lotito. E gjeta në përgjumje, i thërras, më përgjigjet duke lëvizur kokën, më njuh. E puth në ballë; qe hera e fundit.

Një shenjte po përgatitej të ndërronte jetë. Merr veten, ndërsa këndojmë himnet që ajo shumë herë kishte kënduar, shkruar dhe përsiatur: takimin me Dhëndrin që po vjen, festa e dasmës me Dhëndrin, i gostisë Sate mistike, *Simeron kremate*, me Dhëndrin u tret... dhe shumë himne të tjerë ëmbëlsisht kumbonin në veshin e në zemrën e Virgjëreshës dhe Nuses së Krishtit, që me butësi dhe qetësi jepte frymën e fundit në duart e Atij që e kishte krijuar.

Ka vdekur si shenjte, la në zemrat tona një plasje të thellë.

Shëmbëlltyra e gruas së vërtetë, zemërbutë, e përunjur, e qetë dhe e fortë, ka çuar deri në fund luftimin e mirë.

Varrimi i saj u bë të Enjten e Madhe. Mori pjesë mbarë populli, priftërinjtë e katundeve përreth, peshkopi Hirësia e tij imzot Stamati, i cili pas cerimonisë së varrimit, mbajti një fjalim përkujtimor, duke vënë në pah punën e palodhshme të kryer nga zonjusha Rosa në gjirin e eparkisë, Kurse, Jashtë kishës, prof. Mario Pacenza foli për virtytet e kësaj grua.

[Përktheu G. Capparelli - Malcori]

4.5.3 Kujtim i papas Vincenzo Matrangolo

Rosa Lotito: virtytet

‘En si miter akrivòs’...: “ke ruajtur në ty, O Nënë, shëmbëlltyrën hyjnore të paprekshme; në të vërtetë përqafove kryqin dhe ndoqe Krishtin dhe me shembullin tënd ke mësuar jo vetëm të përbuzësh mishin e prishshëm, por gjithashtu të vlerësosh shpirtin, vepër e pavdekshme”.

- Ke qenë lutje e përjetshme: “lutni ngaherë”. Ke qenë llambë gjithmonë e ndezur në pritje të orës së funfit.
- Ke qenë *krìnon en di erìmo*... lule në shkretëtirë.
- Ushqimi yt ishte vepra e shpëtimit tënd: jetoje me liturgjinë dhe me Biblën.
- Në vdekjen tënde: kripë, tharm, farë e bashkësisë së krishtere.
- ke qenë e dëgjueshmja: grua e po-së ndaj Perëndisë, ndaj t’ynë Zoti Jezu, ndaj Kishës, ndaj bashkësisë së vëllezërve të fesë.
- Ke qenë apostulle: ke dashur famullinë, misionet, shoqatën *l’Azione Cattolica*, Universitetin e *Sacro Cuore*, të gërbulurit, përhapjen e liturgjisë së Kishës, shkollën.
- Ke qenë nënë dhe motër, mikeshë dhe kësilltare, ngushëllimtare dhe ndriçuese.
- Ke qenë e durueshme në fatkeqësitë, martire e së vërtetës.
- Ke qenë Jobi: mundimi ka qenë mëlmesa e jetës sate tokësore.
- Me të tre fëmijët brenda furrës: këndove himnin e pavdekshëm.
- Me Pjetrin pohove: “Ti je Krishti, i Biri Perëndisë së gjallë”.
- Me Palin: u dhe pa u kursyer për t’i fituar dishepuj Krishtit.

- Me Marien Nënë: Po, ja shërbetoren tënde, o Zot.
- Nga Krishti more dhe hëngre, çdo ditë, kurmin që ai të dhuronte.

4.5.5 Apostullja

Ti, Grua-Prift: u dhe Perëndisë dhe njerëzve:

Jetë me lutje dhe punë;

Jetë me vuajtje fizike dhe ushtrim virtytesh;

Që kur me pagëzimin takove Krishtin, nuk e braktise më;

Por nise lëvizjen e afrimit përparues kah Ai, duke i hapur udhën embrionit virtual të pagëzimit për të nxjerrë fuqinë e tij hyjnore;

Ke qenë e krishtere për anë të pagëzimit si edhe për jetën që kalove;

Në ngritje të vazhdueshme në fe, në dëgjesë, në dashuri, në pastrim të shpirtit tënd gjithmonë mbi binarin e lutjes dhe të flijimit.

Grua e dëlirë

- 1) mendjeje – mendim i kulluar
- 2) zemre – zemër e dëlirë
- 3) trupi – trup i papërlyer
- 4) gjuhe – gjuhë e pastër.

Shembull urtësie, thjeshtësie, ngulmi.

Ditët e tua kanë qenë pa boshllëqe dhe pa rënie tensioni; kanë qenë një thurje pa asnjë shqepje në indi.

Grua e fortë: përpara çdo lloj vështirësie, që çdo qenie njerëzore është i nënshtruar, ti nuk u lëkunde, por i qëndrove besnike Fesë sate!

Vendose për Krishtin, dhe Krishtin ndoqe, Krishtin imitove, Krishtin yjnizove, Krishtin dashurove, Krishtit i je dhënë, Krishtin shërbeve në vëllezërit e tij të vegjël, në Krishtin dhe shpirt duke buzëqeshur.

Kur do të lexojmë nëpër Ungjijtë fjalët: “Apostujt e Jezuit, dishepujt e Zotit” që sot e tutje ne do të shkruajmë, midis të dymbëdhjetëve, midis të shtatëmbëdhjetëve, midis të pesëqindtëve, midis pasuesve të panumërt të Krishtit, një emër tjetër: Rosa Lotito!

Për të cilën arsye?

- 1) Virgjëreshë: e lidhur vetëm me Krishtin.
- 2) Martire: dëshmove ngaherë Krishtin.
- 3) Grua që lutet: kush mund të numërojë rruzaret e tua? Meshët e tua? Kungimet e tua? Mbrëmësoret e tua? Mëngjesoret e tua? *Paraklisiset* e tua? *Akathistoset* e tua Hyjlindëses?

4) Katekiste e zellshme: përgatisje katekizmin në famulli, në shkollë, me libra dhe me mjete pamordëgjimore, në Kreshmet e Vogla si edhe në të Mëdhat, me gara e çmime për më të mirët.

5) Apostulle e shoqatës “*Azione Cattolica*”: fillove dhe u zotove në këtë shoqatë qysh në fillim; ishte viti 1936, kur Bariu i Eparkisë, imzot Gjon Mele, të njohu, të dallojë dhe të zgjodhi apostulle. Ke qenë kryetare eparkiale të rinisë femërore më parë, dhe pastaj të grave katolike, dhe nuk lije të kalonte ditë pa shkruar një letër qarkore ose një kartolinë vetjake për të shtyrë në organizim takimesh, shoqatash, ditësh studimesh ose vetmish shpirtërore. Nuk kishte famulli pa shoqatë, dhe që të mos ndiente praninë e një mikeshë, të një motre, të një këshilltare, të një zelltare. Deri një mijë, ose më shumë anëtare. Peshkopi dhe Kleri Eparkialë vështronin në ty virgjëreshen e ungjillit të llambës së ndezur, dhe ati i Shenjtë vetë dëshiroi të të dekoronte me titullin e nderit papnor “*Pro Ecclesia et Pontifice*” si shenjë mirënjohje të Kishës për veprën tënde si apostulle.

6) Zelltare e misioneve: delegate eparkiale për le *Pontificie Opere Missionarie*, organizoje “ditën vitore misionare” dhe kujdesshe në mënyrë të qëndrueshme regjistrimet e veprave misionare të *San Pietro, S. Infanzia*, si edhe të *Clero indigeno*.

7) Zelltare në ndihmën gërbulurëve: çdo vit shpërndaje zarfet e lëmoshave, me zell të madh e lutje për vëllezërit të largët të sëmurë nga gërbula.

8) Zelltare e Universitetit *del Sacro Cuore*: gjatë jetës sate dëshirove me gjithë zemër suksesin më të lartë të institutit kulturor të katolikëve italianë.

9) Zelltare e liturgjisë së Kishës: përhape mijëra e mijëra librushka të shaptilografuara me të gjitha lutjet e Kishës duke u lehtësuar besimtarëve pjesëmarrjen në misteret të krishtera të kremtuara gjatë liturgjisë së Kishës. Mbrëmësore, mëngjesore e të dielave, të festave e të Javës së Madhe, tekstin e Meshës së Shenjte, Hymnin *Akàtistos, Paràklisis*, librushkën e lutjeve për djemtë dhe vajzat.

10) Sekretare e famullisë:

a) certifikata pagëzimi, krezmimi, , regjistrime vdekjesh dhe martesash;

b) llogaritare e festave, si edhe të famullisë, e të konviktit;

c) pranime dhe heqje dorë të nxënësve të dy konvikteve;

d) mbledhje ndihmash të ndryshme në famulli.

11) Bashkëthemeluese e “*2° sezione Centro Assistenza preventiva Giovanile*”.

Dole në pension: nuk u mbylle në shtëpi, por nxite që të hapej dega e dytë të Qendrës së Ndhmës ku të pranoheshin djemtë dhe t’u jepej atyre mundësia të vazhdonin shkollën e mesme mbas që të mbaronin filloren.

Me sakrificë të madhe, le shtëpinë tënde dhe u vendose në mjediset e konviktit, dhe aty u bëre këshilltarja dhe e besuarja e çmuar të nxënësve të mitur që në ty hapnin zemrat e tyre.

12) Bashkëthemelues e grupit famullitar shpirtëror: për disa vjet braktise shtëpinë dhe u vendose në shtëpinë e përgatitur si oazë lutjesh dhe studimi të frymës shpirtërore të krishtere: “Shtëpia e “Akatistines”.

[Përktheu G. Capparelli - Malcori]
Papas Vincenzo Matrangolo Famullitar.

4.6 Një murgeshë revolucionare

Maria Delfina Rossano lindi Firmozë më 26 nëntor 1933 nga Michelangelo dhe Mariangela Natì, buronte nga një familje e pasur çifligare.

Nga të dhënat e të vëllait, ende i gjallë: Ajo mbaron shkollën fillore në fshatin e lindjes, dhe pastaj kalon në Rossano pranë familjes Tocci (një familje e pasur avokatësh, e afërme me familjen tonë) ku nisi shkollën e mesme.

Si kreu tetëvjeçaren, braktisi shkollën. Ishte zakon, aso kohe, që vajzat në atë moshë ishin gati për t’u martuar, dhe si arriti shtatëdhjetëvjeç, i Goffredo (familja e gjyshes atërore, së cilë i përkisnin shumë anëtarë mjekë dhe noterë) u angazhua ta fejonte me mblesëri, gjer sa arriti të kombinonte fejesën; por Maria s’pranoi, nuk kishte asnjë prirje për fejesë dhe martesë.

Te Maria Delfina, gjatë kësaj periudhë, fillon të formohet ndjeshmëria shoqërore. Pavarësisht se buronte nga një familje e pasur çifligarësh, ajo ka qenë gjithmonë pranë dhe ka mbështetur fuqimisht demonstratat e masave të gjera punonjësve të nënshtruara shtëpive të pronarëve që i shfrytëzonin.

Mbasi tre vjet, si arrin të bind familjen, në veçanti të atin, i krijohet mundësia për të vazhduar shkollën, dhe shkon në Palermo pranë institutit të Teresianeve (Urdhër fetar laik) ku merr maturën në ekonomi shtëpiake, që, aso kohe, i jepte mundësinë të punësohej si mësuese nëpër shkollat e mesme të ulëta. Dhe, sipas zakonisht të Teresianave, emërohet mësuese, dhe punon në një shkollë të mesme në Palermo deri në vitin 1959. Po në këtë vit lë Palermo dhe vendoset në Perugia, ku, pa dijeninë e tersianave të tjera, njeh dhe fillon të shoqërohet me zotërinë Aldo Capitini, i cili pohonte se ishte një murg laik dhe përhapte në Itali mendimet e Ghandit. Në vitin 1961, Maria Delfina merr pjesë në marshimin e parë të Paqes “Perugia-Assisi”, marshim i themeluar nga Aldo Capitini. Gjatë atij manifestimit, për herën e parë, valëvitet Flamiri i Paqes.

Në vitin 1963 shkon në Madrid, selia qendrore e urdhrit të Teresianave, ku qëndron deri në vitin 1970. Po këtë vit i vdes i ati, dhe ajo veçohet në Aix-en-Provence, vendi i vetëmisë së Urdhrit.

Si mbaroi “përvoja spanjolle”, kthehet tek shtëpia e Teresianave në Perugia, ku fillon të frekuentojë urdhrin e Motrave të Vogla të Charles de Foucauld, urdhër që i kushtohet të varfërve që mjerisht jetonin në skaj të shoqërisë.

Nga viti 1971 deri në vitin 1973 zgjat rishtaria, dhe shugurohet murgeshë në Romë, dhe, mbasi një qëndrim shumë të vogël në qytetin e Romës, dërgohet me shërbim në Prishtinë të Kosovës.

Jeton në Prishtinë që nga viti 1974 deri në vitin 1980; gjatë kësaj periudhë kalon gjashtë muaj në shkretëtirën e Saharas, në vendet e Charles de Foucauld, ku merr pjesë në vetminë shpirtërore. (Charles Eugene de Foucauld, viskont Pontbriand, rregulltar francez i njohur me emrin Fratel Carlo i Jezuit, eksplorues dhe njohës i shkretëtirës sahariane dhe lëvrues i gjuhës dhe të kultures Tuareg: më 13 nëntor 2005 Papa Bendikti XVI e lumturoi).

Disi e pakënaqur, në vitin 1982 del nga urdhri “delle Piccole Sorelle”, me pëlqimin e eprorëve. Megjithatë, ajo nuk braktisi kurrë jetën prej murgeshë, qoftë në sjellje qoftë edhe në veshje.

Kthehet në shtëpinë amënore, pallati Rossano, tash bosh: krejt familja jetonte në Catanzaro. Për të siguruar pavarësinë ekonomika, fillon të punojë si shtëpiake pranë një familje në Destro, me të cilën familja Rossano kishte lidhje farefisnore.

Janë vitet (që nga gushti i 1985) që misdis Arbërisë dhe Shqipërisë zhvillohen bashkëpunime kulturore, Maria Delfina merr pjesë. Kjo përvojë e frymëzon atë sa i kushtohet gjuhës dhe traditave arbëreshe, përgatit dhe boton, me tirazh të vogël, një mbledhje Kalimeresh.

Vendoset përfundimisht në katundin e lerjes ku, për të plotësuar vitet e punës, punon si mëditëse në bujqësi. Lidhet me lëvizjen e Priftërinjve Punëtorë, duke marrë pjesë në mitingjet e tyre në Itali dhe jashtë Italisë. Priftërinjtë Punëtorë janë një shoqatë që lindi në Francë në vitin 1943; gjatë viti 1954 fajësohen si komunistë dhe Papa Pio XII u nadol priftërinjve të gjithë të punësohen nëpër fabrika “nga frika e një ndryje intelektuale dhe morale të mundshme”, vetëm në vitin 1965 riaftësohen nga Papa Paolo VI.

Kah mbarimi i viteve 80 kujdeset për nënën e sëmurë, fillimisht në Firmozë dhe periudhën e fundit në Katanxaro. Mbas vdekjes së ëmës kthehet Firmozë, vaxhdon të punojë mëditëse në bujqësi dhe njëkohësisht angazhohet në një komunitet toksikomanësh në Spezzano Albanese.

Në Bari e gjejmë si përkthyes duke ndihmuar shqiptarët që lanë Shqipërinë mbas ngjarjeve të vitit 1990.

Angazhim shoqëror (mbledhje, demonstrata) dhe përsiatje në të ashtuquajturin “Eremo dell’Addolorata” në gjirin e shtëpisë atërore, mbushin ditët e saj që tash e tutje.

